



• ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE  
NEWSLETTER  
KORRIK 2007, NR.28

## Java e Kuvendit



**Deputetët e Kuvendit të Kosovës takohen  
me njerëzit që ata përfaqësojnë**

## EDITORIAL



Kuvendi i Kosovës është duke operuar në disa fusha në të njëjtën kohë. Detyra dhe obligime që nuk përmbushen lehtë nga një parlament i ri. Ndërkohë që është duke punuar në zbatimin e përgjegjësi të cilat konsiderohen të jenë 'normale' për çdo parlament demokratik, Kuvendi, gjithashtu, është duke zbatuar reforma brenda administratës së tij, si dhe duke qenë afër zgjedhësve të vet.

Në të njëjtën kohë, Kuvendi është duke i bërë përgatitjet për periudhën e tranzicionit dhe duke i përmbushur obligimet e veta për miratimin e ligjeve të parapara me Propozimin për zgjidhjen e statusit të dorëzuar nga i Dërguari i Posaçëm, Presidenti Ahtisaari, në Këshillin e Sigurimit.

Gjatë muajve të fundit, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë shfrytëzuar kohën për t'u takuar me njerëz të komunave të ndryshme anembanë Kosovës. Gjatë këtyre takimeve, nxënësit, mësimdhënësit, studentët dhe gjithë qytetarët tjerë kishin mundësi që t'i parashtronjë pyetje Kryetarit të Kuvendit dhe deputetëve tjerë. Pyetjet e parashtruara gjatë këtyre takimeve kishin të bënin me punën dhe strukturën e Kuvendit, procesin legjislativ, punën e komisionit, planet e Kuvendit për politika të arsimit e deri te statusi dhe simbolet kombëtare. Derisa këto aktivitete kryheshin nga disa Deputetë, deputetë të tjerë kishin hapur zyra në rajonet e tyre përkatëse në mënyrë që të jenë sa më afër qytetarëve. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve gjithashtu organizoi vizita në terren në komuna të ndryshme për të marrë informata të sakta për fushëveprimin e saj.

Ky edicion i Buletinit të ASI përmban opinione dhe intervista mbi zhvillimet 'për dhe rreth' Kuvendit. Fuqizimi i punës së Kuvendit përmes reformave dhe ndryshimeve në personel janë përshkruar në intervistën me z. Ismet Krasniqin – sekretar i përhershëm i Kuvendit. Në një intervistë tjetër, kryesuesi i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion, z. Ibush Jonuzi, shtjellon hapat e ndërmarra nga Komisioni, për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve.

Me përkrahjen e OSBE-së dhe partnerëve tjerë të ASI-t, Kuvendi organizoi Javën e Kuvendit dhe Konferencën parlamentare për sektorin e sigurisë dhe rendit publik.

Në përfundim, dëshirojmë t'i falënderojmë të gjithë ata që kontribuuan në Buletinin e ASI-të dhe njëkohësisht ju ftojmë të na dërgoni komente apo artikuj për publikimet e ardhshme.

*Franklin De Vrieze,*

*Assembly Support Initiative Co-ordinator.*

|  |    |
|--|----|
| Editorial  | 2  |
| In Memoriam - Dëfrim Krasniqi  | 3  |
| Java e Kuvendit  | 4  |
| Zbatimi i Ligjit mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve   | 5  |
| Grupi më i ri Parlamentar në Kuvendin e Kosovës  | 7  |
| Reformat kanë filluar në Administratën e Kuvendit  | 8  |
| Konferenca Parlamentare në Kosovë mbledhë përfaqësuesit nga 10 Kuvende                           | 10 |
| Grupi Joformal parlamentar i Grave në Kuvendin e Kosovës   | 12 |
| Anëtarët e Kuvendit dëgjojnë zërin e qytetarëve  | 13 |
| Procesi Kushtetues   | 15 |
| Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve viziton komunitetet në Komunitat e Kosovës | 16 |
| Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë si vegël e luftimit të korrupsionit                   | 18 |
| Kthimi i goranëve në Kosovë është jetik  | 19 |
| Një vështrim mbi punën e Kuvendit  | 21 |
| Përshtypjet për Kuvendin e Kosovës nga një ish-Parlamentare                                      | 22 |
| Duke u fokusuar në mjedis  | 24 |
| Angazhimi i asistentëve të përkohshëm: Një hap tjetër drejt përforcimit të rolit të Komisioneve  | 25 |
| Ndikimi i Planit të Standardeve të Kuvendit  | 26 |
| Ligji i Bullgarisë kundër Diskriminimit dhe roli i OJQ-ve në avokimin dhe zbatimin e tij         | 27 |



## Përkujtim Dëfrim Krasniqi

(1958 - 2007)

Kuvendi do të kujtojë shokun dhe kolegun.

Në këtë moment të pikëlluar, shokët dhe kolegët nga Kuvendi i Kosovës dëshirojnë të shprehin ngushëllimet më të thella, dhe t'i bëjnë homazh Dëfrimit për personalitetin dhe cilësitë e tij profesionale.

Dëfrimi na e ka lënë një përshtypje të një njeriu me karakter dhe aftësi të veçanta, por gjithashtu edhe të një njeriu me një qëndrim të lartë profesional dhe juridik. Ai vepronte si një "filtrues" i Kuvendit duke kontrolluar secilin nen të ligjeve të shumta të cilat kanë kaluar nëpër Kuvend. Si njëri që punonte me ndjenjë më të lartë të përkushtimit, Dëfrimi ishte gjithnjë i gatshëm për të pranuar këshilla nga kolegët e tij, dhe asnjëherë nuk ankohej për punët e shumta që kryente.

Në këtë aspekt, veprimtaritë dhe angazhimet e tij të shumta na dhanë një mundësi të kufizuar për të patur takime personale me të, por ndjenja e tij e përkushtimit dhe përgjegjësisë është treguar kur sekretari kërkoj nga ai që të shoqëroj një delegacion të parlamenteve Belge dhe Franceze në Kuvend; përgjigja e tij e parë ishte; "le të shkoj dikush tjetër në vend timin, kam shumë punë për të bërë!" Me insistim të sekretarit ai u pajtua që të shkojë, por kur u kthye kërkoi që për vizitat në të ardhmen ai dëshiron që të zëvendësohet, pasi që kjo pjesëmarrje e kishte penguar



atë në përmbushjen e detyrave të tij.

Dëfrimi kishte një profesionalizëm, forcë, dëshirë, përkushtim, dhe gatishmëri për të përmbushur të gjitha detyrat të cilat i kishte.

Sot, mund të ju them se pas disa komplikimeve shëndetësore Kryeparlamentari z. Kolë Berisha, i ofroi atij mundësinë që të merr pushim, ofertë kjo që u refuzua sepse Dëfrimi dëshironte që të vazhdonte me punën e tij. Përkushtimi i tij i vazhdueshëm ndoshta e kishte maskuar nivelin e vërtetë të sëmundjes së tij, e cila e mori atë nga ne aq shpejtë një një moshë aq të re, në kohën kur shumë patën pritje të mëdha për të, së pari familja e tij, por edhe ne në Kuvendin e Kosovës.

Në ora 10:00 të martën e 6 marsit 2007 në u njoftuam për vdekjen e papritur të Dëfrimit. Ai tani është pjesë e kujtimeve dhe krenarisë sonë, të cilat do të vazhdojmë ti kultivojmë; ne jemi krenar që e kemi quajtur shok dhe kolegë, dhe kujtimet për të do të na mbesin përgjithmonë!

Dëfrim, të faleminderit për gjithë kontributin tënd gjatë punës në administratë të Kuvendit të Kosovës!

Lamtumirë, shoku dhe kolegu jonë i dashur dhe i mirë!

*E hartuar në bazë të fjalimit lamtumirës të mbajtur nga sekretari i Kuvendit të Kosovës, z. Ismet Krasniqi, të mërkurën 7 mars 2007*



# Java e Kuvendit

## Deputetët e Kuvendit të Kosovës takojnë zgjedhësit e tyre

Hasan Sopa, Misioni i OSBE-së në Kosovë

*Kuvendi i Kosovës lansoi një fushatë për kontaktim me opinionin publik të quajtur 'Java e Kuvendit', të iniciuar nga Misioni OSBE-së në Kosovë. Për një javë, anëtarët e Kuvendit të Kosovës kishin udhëtuar nëpër qytetet më të mëdha të Kosovës dhe kishin takuar qytetarët, studentët dhe zyrtarët vendor. Kjo ishte hera e parë që ishin përpjekur për të krijuar kontakte më të afërta me qytetarët dhe për të përmirësuar lidhjet e komunikimit ndërmjet nivelit qendror dhe lokal.*

Misioni i OSBE-së në Kosovë i ka ofruar ndihmë substanciale Kuvendit të Kosovës që nga inaugurimi në dhjetor të vitit 2001. Monitorimi i zhvillimit legjislativ; fuqizimi i grupeve parlamentare; përmirësimi i ndërveprimit ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë; përmirësimi i planifikimit buxhetor dhe kontrollit të shpenzimeve; si dhe mbrojtja e interesave të komuniteteve pakicë janë vetëm disa prej lëmive ku OSBE-ja luan rol të posaçëm.

Sipas Franklin De Vrieze, Udhëheqës i Njësisë së Misionit për Kuvend Qendror, OSBE-ja në veçanti ishte përqendruar në lëmit e ngritjes së kapaciteteve dhe në programet e demokratizimit. "Në pesë vitet e fundit", siç thotë ai, "Misioni ka ofruar një numër të konsiderueshëm të trajnimeve dhe seminareve për të përmirësuar cilësinë e punës së Kuvendit të Kosovës".

### Kontaktet me publikun

Praktikat e deritanishme të Kuvendit të Kosovës përf-



shijnë fare pak aktivitete për përafrim me publikun nga zyrtarë publikë apo të nivelit lokal. Zyrat komunale dhe rajonale të partive politike janë të vetmet lidhje të komunikimit me publikun në përgjithësi.

Për të sjellë anëtarët Kuvendit të Kosovës më afër me qytetarët, prej 21 majit deri më 5 qershor të vitit 2007, OSBE-ja organizoi dhe promovoi vizita me zgjedhësit në pesë rajone të Kosovës.

Secila vizitë kishte përfshirë takimet me nxënësit e shkollave të larta, me zyrtarë vendor, si dhe takime me publikun e gjerë nëpër sallat e kuvendeve komunale. Pyetjet e parashtruara për deputetët e Kuvendit në këto takime ishin të drejtpërdrejta dhe të qëlluara, gjë që tregonin që publiku ishte i interesuar dhe i brengosur për procesin par-

lamentar dhe politik.

Siç thotë koordinatori i misionit, Bujar Maxhuni "këto vizita ishin mundësi unike për deputetët e Kuvendit për të kontaktuar me popullatën". "Ata kishin diskutuar një sërë çështjesh relevante, siç janë procesi i hartimit dhe fuq-

izimit të ligjeve, ndarja e kompetencave ndërmjet nivelit qendror dhe atij vendor, si dhe për procesin për statusin përfundimtar të Kosovës."

### Përfitimet e ndërsjella

"Ky ka qenë një takim shumë i rëndësishëm," tha Erzana Kryeziu, nxënëse e Shkollës së Mesme 'Sami Frashëri', e cila kishte marrë pjesë në takim në Prishtinë. "Për herë të parë kemi folur drejtpërdrejt me deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe diskutuam çështjen më të rëndësishme për ne, arsimin."

Kumrije Kallaba, Drejtoreshë e Shkollës së Mesme Sami Frashëri, ishte shumë krenare që shkolla e saj ishte zgjedhur si nikoqire për deputetët e Kuvendit të Kosovës. "Kjo është hera e parë që Kryetari i Kuvendit të Kosovës ulet në të njëjtën klasë me studentët dhe dëgjon brengat që ata i preokupojnë," tha ajo.





Në anën tjetër, në takim me qytetarët deputetët e Kuvendit ishin ballafaquar me pyetje më të rënda, posaçërisht me ato që kishin të bënin me zgjedhjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Nganjëherë ata nuk e kishin ndier vetën rehat prej pyetjeve të parashtruara, por prapë ata ishin të lumtur që ishin në mesin e popullatës.

“Kjo është pjesë e demokracisë” – tha Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kolë Berisha në njërin nga takimet me qytetarët në Mitrovicë.

“Këto diskutime ndihmojnë përafrimin e institucioneve me popullin, dhe vërtetë shpresoj që kjo të bëhet praktikë në të ardhmen,” tha anëtari i kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Sabri Hamiti. “Ata kanë të drejtë të dinë se çka bëjmë ne”, tha ai dhe konsideron këtë si parim të institucioneve demokratike.

## Aktiviteti i çmuar

Kjo iniciativë, është dëshmuar të jetë aktivitet shumë i çmuar i konceptit të kontaktit me publikun dhe Kuvendin, e

cila kishte mundësuar që të plotësohen zbrazëtitat ndërmjet strukturave të nivelit qendrorë dhe vendore.

Sipas Maxhunit, ky projekt paraqet bazë për aktivitetet e ardhshme të kontaktit me publikun, dhe se Misioni ka për qëllim që të zhvillojë iniciativa tjera përcjellëse. Me sistemin zgjedhor të Kosovës i cili pritet të ndërrohet në atë me lista të hapura, kontakti i drejtpërdrejt ndërmjet deputetëve të Kuvendit të Kosovës me qytetarët është duke u bërë shumë i rëndësishëm si për politikanët, ashtu edhe për zgjedhësit.

Në fund Maxhuni thotë: “për një demokraci funksionale, është shumë i rëndësishëm shkëmbimi i informatave për punën dhe funksionimin e Kuvendit të Kosovës, gjë që ndihmon edhe në përmirësimin e imazhit të Kuvendit. Ne shpresojmë që aktivitetet e kontaktit me publikun në të ardhmen të vazhdojnë të mbahen nga ana e Kuvendit, dhe që OSBE-ja do të ketë vetëm rol këshillëdhënës dhe përkrahës.”

# Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve

*Intervistë me z. Ibush Jonuzin, kryesues i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion*

Më 13 Prill 2007, Kuvendi i Kosovës shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Raportin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion (ETIETT), mbi zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve. Në këtë Raport, Komisioni ka paraqitur të gjeturat më të rëndësishme si dhe ka përpiluar një listë rekomandimesh për Ministrinë për Tregti dhe Industri.

**ASI: Si lindi ideja për një iniciativë të tillë në Komisionin tuaj, duke pasur parasysh që deri tani Kuvendi i Kosovës nuk ka bërë shumë për të mbikëqyrur punën e Qeverisë së Kosovës?**

IJ: Komisioni për ETIETT përfshin një fushëveprimtari shumë të gjerë duke mbuluar katër ministri të Qeverisë së Kosovës. Sipas Rregullës 53 të Rregulloresë Punës së Kuvendit të Kosovës, komisionet parlamentare kanë të drejtë të monitorojnë zbatueshmërinë e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Pyetjes juaj se si lindi ideja për një iniciativë të tillë do t'i përgjigjesha me një falënderim të posaçëm për NDI-në, për ndihmën e pazezervë që i ofruan Komisionit tonë gjatë gjithë kohës së ushtrimit të këtij aktiviteti. Përzgjedhja e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit është bërë nga komisioni duke marrë parasysh se ky ligj ndikon në jetën e të gjithë qytetarëve të

Kosovës.

**ASI: Në çfarë aktiviteteve është angazhuar Komisioni për të kuptuar më mirë shkallën e zbatimit të ligjit?**

IJ: Pas marrjes së vendimit, nga ana e Komisionit për ligjin që do të monitorohet, kemi emëruar një grup punues prej pesë anëtarëve me përbërje: Ibush Jonuzi, Bajrush Xhemajli, Xhevdet Neziraj, Milazim Haliti dhe Genc Gorani. Ky grup punues ka përpiluar planin e punës i cili pastaj është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni. Duke u bazuar në planin e punës, Komisioni ka filluar me vizita në terren, duke vizituar Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Me këtë rast do të dëshiroja të falënderoja Ministrin Dugolli dhe gjithë personelin e ministrisë për bashkëpunimin me Komisionin. Ministria ka qenë e gatshme të sigurojë çdo informatë të cilën e kemi kërkuar lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve. Komisioni ka vizituar pesë komuna, Ferizajin, Klinën, Gjilanin, Prishtinën dhe Pejë. Pastaj kemi mbajtur takime me përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës, Aleancës Kosovare të Biznesit, inspektorët regionalë dhe komunalë. Gjatë organizimit të këtyre vizitave, problemin më të madh e kemi pasur në kontaktimin e përgjegjësve të Shoqatës për Mbrojtjen



e Konsumatorëve. Komisioni, pas disa përpjekjeve të pasuksesshme, ka kuptuar se kjo Shoqatë në të vërtetë nuk ekziston fare dhe se në të kaluarën kanë ekzistuar iniciativa të disa individëve për formimin e një shoqate të tillë. Formimi i Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka qenë një nga rekomandimet tona që kemi bërë për Ministrinë për Tregti dhe Industri.

**ASI: Cilat kanë qenë sfidat kryesore me të cilat janë ballafaquar anëtarët dhe stafi i Komisionit gjatë vizitave në terren?**

IJ: Sfidat kryesore me të cilat jemi ballafaquar kanë qenë kryesisht të natyrës teknike dhe logjistike. Kuvendi i Kosovës na ka ndihmuar duke na ofruar një veturë për vizitat tona në terren. Përndryshe, përkrahje tjetër nuk kemi pasur. Përmbyllja me sukses e këtij aktiviteti është meritë, kryekëput e anëtarëve të Komisionit dhe personelit mbështetës - gjë që e theksova edhe në fjalimin tim gjatë seancës plenare.

**ASI: Çfarë ishte gatishmëria e zyrtarëve qeveritarë për bashkëpunim me Komisionin?**

IJ: Kemi hasur në mirëkuptim dhe në gatishmëri të plotë në të gjitha komunat dhe institucionet të cilat i kemi vizituar. Kryetarët e komunave, së bashku me shefat e ekzekutivë komunale kanë ftuar në takim edhe drejtorët përkatës komunalë, përgjegjës për këtë lëmi.

**ASI: Cilat ishin gjetjet më të rëndësishme të Komisionit gjatë monitorimit të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve?**

IJ: Niveli i zbatimit të ligjit, nuk ka qenë në të gjitha komunat njësoj, kurse sa i përket ndërmarrjeve prodhuese vendore, Komisioni ka konkluduar të ketë nivel të kënaqshëm të zbatimit të ligjit. Prodhuesit tanë kanë respektuar dispozitat e ligjit lidhur me klasifikimin e prodhimeve në bazë të kualitetit dhe kohëzgjatjes së afatit të përdorimit. Qytetarët (konsumatorët) i kemi pyetur nëse janë të njoftuar me ekzistimin e Ligjit i cili mbron të drejtat e tyre. Komisioni ka

konstatuar se, përkundër fushatës së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vetëdijësimin e qytetarëve, shumë pak qytetarë janë të njoftuar me ligjin dhe dispozitat e tij. Ndërmarrjet publike i kemi vizituar në të gjitha komunat e lartpërmendura. Mund të theksojë që gjendja më e mirë është në ndërmarrjet publike në Prishtinë. Vlen të përmendet Ujësllësi Rajonal "Prishtina", e cila përkundër vështirësive për inkasimin të faturave dhe leximit paushall të njehsorëve, është një ndër ndërmarrjet tek e cila kemi hasur gatishmëri të veçantë në respektimin e dispozitave të Ligjit. Për më tepër, kjo kompani ka filluar me hapjen e zyrave për konsumatorët, në mënyrë që t'ua lehtësojë qytetarëve njoftimin me problemet në rrjetin e ujësllësit dhe pagesën e faturave. Si zakonisht, ka vërejtje në furnizimin me energji elektrike si dhe me leximin me vonesë të njehsorëve, gjë që ngarkon edhe më shumë faturat edhe ashtu të shtrenjta të ujit. Qytetarët në Komunën e Klinës/Klina janë ankuar edhe për tensionin e ulët elektrik i cili po ua dëmton aparatet e amvisërisë.

**ASI: Komisioni ka dhënë një sërë rekomandimesh për Ministrinë për Tregti dhe Industri. Çfarë do të ndërmarrë Komisioni juaj për të siguruar që rekomandimet nga Raporti të merren parasysh nga Ministria?**

IJ: Me këtë ligj është bërë një përparim i madh, por problemet tjera nuk mund të zgjidhen vetëm me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve. Mbrojtja e konsumatorëve mund të arrihet vetëm me zbatimin e ligjeve tjera sepse në mbro-

jtjen e konsumatorëve duhet të vihen edhe një sërë ligjesh tjera, të cilat duhet të hartohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Energjetikës dhe Minierave. Në raportin e Komisionit kemi detajizuar disa prej ligjeve të domosdoshme siç janë: Ligji për Veterinarinë, Ligji për Plehrat Artificiale, Ligji për Pesticidet, Ligji për Farërat dhe Ligji për Inspektoratin Sanitar. Një infrastrukturë solide ligjore në këtë fushë, do të siguronte konsumatorin kosovar, ashtu siç edhe e meriton.

Komisioni i ka paraqitur 11 rekomandime, të cilat unanimisht janë miratuar në Seancën Plenare, me ç'rast Komisioni ka marrë shumë komplimente për punën e tij. Ne, sigurisht që do të përcjellim dhe monitorojmë aktivitetet e Qeverisë lidhur me implementimin e rekomandimeve të Komisionit. Disa rezultate janë dhënë, si p.sh që Ministria ka shpejtuar punën rreth përpilimit të Programit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe ka ofruar përkrahjen e saj në formimin e Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve në nivel kombëtar.

**ASI: A planifikon Komisioni aktivitete të ngjashme në të ardhmen?**

IJ: Komisioni tanimë ka filluar me përgatitjet për monitorimin e Ligjit për Transportin e Mallrave të Rrezikshme. Komisioni konstaton që ky Ligj ka rëndësi të veçantë posaçërisht pas rastit të fundit të importimit të naftës dhe derivateve të saj.

Arben Kelmendi,  
National Democratic Institute



# Grupi më i ri parlamentar në Kuvendin e Kosovës

Intervistë me z. Ramadan Kelmendi, Shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD)



Më 10 maj 2007, Kryetari i Kuvendit njoftoi për formimin e një Grupi të ri Parlamentar – Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD).

**ASI: z. Kelmendi, si Shef i Grupit Parlamentar të LDD-së, cila është gjendja e aktiviteteve të grupit tuaj në Kuvend?**

Ramadan Kelmendi: Është fat i mirë që pas një kohe pa ndonjë arsye të zgjatur, ku jemi ballafaquar me pengesa brenda Kuvendit, Kuvendi është njoftuar zyrtarisht për krijimin e Grupit të ri Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Ndonëse kjo procedurë është kryer, ne akoma nuk i kemi kushtet as elementare për punë. Nuk na është siguruar zyra e punës, kompjuteri, teknika administrative dhe mundësitë tjera. Nuk na janë ndarë mjetet financiare që na takojnë për vitin 2007. Për të gjitha këto kemi deponuar kërkesën me shkrim dhe shpresoj që vendimet e Kryesisë së Kuvendit do

t'i realizojë Sekretari Permanent i cili edhe është i autorizuar të bëjë ekzekutimin e vendimeve të Kryesisë. Është krejt normale dhe logjike që në rast të mos përmbushjes së këtyre kushteve brenda afatit ligjor, ne do të detyrohemi që të adresojmë këtë çështje institucioneve tjera relevante për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat tona.

**ASI: Si grup parlamentar, a planifikoni tani të bëni më shumë pyetje për Qeverinë sesa kur keni qenë pjesë e LDK-së?**

RK: Grupi ynë planifikon që potencialin profesional dhe përvojën e gjatë të Kuvendit ta shfrytëzojë për të shqyrtuar përmbajtjen e ligjeve që vijnë në Kuvend duke paraqitur vërejtje, sugjerime në komisionet ku jemi anëtarë dhe në komisionet funksionale, si dhe në veçanti gjatë leximit të parë të projekt-ligjeve në Kuvend. Sikurse edhe deri më tani, edhe në të ardhmen Grupi Parlamentar i LDD-së do të paraqesë amendamente në ato dispozita të cilat konsiderohen se duhet begatuar dhe harmonizuar me legjislacionin e BE-së

**ASI: Si e shihni grupin tuaj në kuvend? Shumicë apo opozitë?**

RK: Si grup i ri, ne në radhë të parë jemi të përqendruar të zbatojmë Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe të mbështesim parimet e shtetit ligjor për një shoqëri të hapur; ku në radhë të parë do të çmohen

vlerat humane dhe njerëzore, kombëtare dhe profesionale, dhe ku nuk ka urrejtje dhe hakmarrje. Ne nuk do të mbështesim armiqërinë mes atyre që gjenden në pushtet dhe atyre që gjenden në opozitë, por do të jemi aty për të votuar për interesat e përgjithshme të qytetarit të Kosovës dhe për demokracinë qytetare.

**ASI: Çfarë janë marrëdhëniet e juaja me anëtarët e Kuvendit nga LDK-ja?**

RK: Personalisht, deri më tani nuk kam vërejtur të jenë ftohur marrëdhëniet me

LDK-në në ndonjë mënyrë. Unë deri tani kam patur marrëdhënie të mira dhe do të bëj mundohem të kem marrëdhënie të mira edhe më tutje si deputet edhe si qytetar. Gjithashtu edhe me subjektet e tjera politike kemi marrëdhënie të mira. Ne nuk dëshirojmë të krijojmë kriza politike e as parlamentare përderisa të tjerët nuk vënë në një situatë të tillë. Këtë ua kemi dëshmuar të gjitha partive politike shumë herë. Prandaj e njëjta vlen edhe për LDK-në.

**ASI: Pse atëherë jeni ndarë?**

RK: Ndarja tanimë është e qartë për të gjithë. Nuk është pasojë e marrëdhënieve ndër-njerëzore, por pasojë e raporteve të krijuara në bazën e zbatimit të statutit dhe procedurave të Zgjedhjeve të Gjashta me radhë të LDK-së, që nga kuvendet e aktiveve deri tek Kuvendi i VI-të Zgjedhor ku u bënë shumë shkelje procedurale dhe statutare.

**ASI: Pse jeni zgjedhur ju Shef i Grupit parlamentar e jo z. Daci apo ndonjëri nga anëtarët tjerë të grupit?**

RK: Deri tani për këtë nuk më ka pyetur asnjëri, por kryesia e LDD-së dhe në veçanti akademik Daci vlerësojnë kontributin tim paraprak politik dhe si deputet në dy mandate, dhe për këtë është vendosur në mënyrë unanime. Kështu mbase edhe për të mos ardhur deri tek ushtrimi i funksioneve të dyfishta që do të ndodhte për shembull me zgjedhjen e akademik Dacit siç thoni ju.

**ASI: Cili ministër në Qeverinë e Kosovës është më i preferuari nga ana e grupit tuaj parlamentar?**

RK: Unë për vete nuk do të bëja këtë ndarje: në ministra të preferuar dhe jo të preferuar, por të gjithë do t'i këshilloja që funksionin ta ushtrorjnë në maksimum në mbështetje të parimit të ligjshmërisë, dhe që mjetet e shoqërisë me të cilat disponojnë ti shfrytëzojnë në mënyrë racionale. Mendoj që Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale po ia del mbanë që të ruajë qetësinë sociale përkundër buxhetit të vogël që ka, ballafaqimit të madh me papunësinë si dhe me një numër të madh të asistencash sociale (si p.sh të invalidëve të luftës, të punës etj). Nuk duhet harruar as shpërndarjen reale buxhetore të MEF-it.

Ramadan Islami,  
Misioni i OSBE-së në Kosovë

# Reforma në administratën e Kuvendit ka filluar

**Projekti i financuar nga BE-ja 'Mbështetja për Kuvendin e Kosovës', që implementohet nga Konsorciumi i Parlamenteve të Gjermanisë, Francës dhe Sllovenisë dhe nga 'Institut International de Paris La Defense', kanë filluar procesin e reformave në administratën e Kuvendit, për të modernizuar administratën.**

**Kuvendi si tërësi është konsultuar për përmbajtjen e reformës dhe ka marrë zotimin për të implementuar pakon e reformave. ASI ka intervistuar Ismet Krasniqin, Sekretar i Kuvendit, për të marrë mendimet e tij lidhur me reformën.**

*Intervistë me Ismet Krasniqin, Sekretar i Kuvendit të Kosovës.*



**ASI: Cili është qëllimi i reformës dhe cilat janë elementet pozitive kryesore të kësaj reforme?**

Ismet Krasniqi: Në radhë të parë, sa i përket reformës, fillimisht kisha shprehur falënderimet e mia të veçanta për projektin nga Parlamentet e Konsorciumit, i cili ka ofruar mbështetje për punën e Kuvendit të Kosovës. Kjo mbështetje është përqendruar në dy dimensione: administratën edhe personelin politik. Për rrethanat tona, termi reformë do të thotë një përpjekje për avancimin, funksionalizimin dhe organizimin më të mirë të punës së Kuvendit. Fillimisht do të doja të theksoja se procesi i reformës kërkon një qasje shumë serioze për punën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës.

**ASI: Çka parasheh kjo reformë sa i përket organizimit të administratës?**

IK: Mund të them se Administrata ka qenë kompatible me kohën në të cilën është organizuar Kuvendi, por nevoja dhe dinamika e zhvillimeve të punëve e ka paraqitur nevojën për organizimin edhe të vetë administratës së Kuvendit. Kjo ka rezultuar me një pako të disa rregullave dhe rregulloreve në përputhje me të cilat kemi ndërmarrë organizimin e administratës. Një përqendrim i veçantë në organizimin e administratës është shprehur përmes ndryshimit dhe plotësimit të Udhëzimit Administrativ nr. 2000/31. Ky amendamentim mundëson ndryshimin në Udhëzimin Administrativ për nëpunësit civil të Kosovës, me të cilin

Kuvendit të Kosovës i lejohet të dallohet nga institucionet tjera sa i përket punësimit të personelit, pagave të personelit, orarit të punës dhe të gjitha çështjeve tjera të cilat e avancojnë punën e Kuvendit.

**ASI: Çfarë për statusin e personelit?**

IK: Këto reforma kanë rezultuar me ndarjen e personelit civil në dy grupe: në zyrtarët civil apo shërbyesit civil dhe zyrtarët apo mbështetësit e personelit politik. Zyrtarët duhet të jenë persona profesionist, personeli civil i cili është i përkushtuar për atë punë, pasi që sipas këtyre rregulloreve, nga shtatori do të kemi kontrata të përherëshme pune për këta zyrtarë. Ndërsa personeli politik është në pozitë më të mirë sa i përket kompensimeve për faktin se pagat e tyre do të jenë për njëzetë përqind më të larta, ata e ndajnë fatin e mandatit të personelit politik të Kuvendit të Kosovës. Kjo rritje e kompensimit prej njëzetë përqind mbulon, pa keqkuptim, rrezikun e përfundimit të mandatit.

**ASI: Çka për mbështetjen e punës së deputetëve dhe të menaxhmentit?**

IK: Këta janë dy sektorë; dy segmente shtesë të cilat me këto rregulla do të kenë një avancim. Sa u përket deputetëve, ne kemi përkush-

timin dhe angazhimin e personelit që është i aftë të kryejë të gjitha punët e nevojshme teknike dhe administrative në mënyrë që deputeti të jetë i përkushtuar në funksionin e tij/saj politik. Segment tjetër i veçantë në këto reforma është menaxhimi i buxhetit pasi që nevojat po rriten vazhdimisht dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha kërkesat. Duhet vënë në dukje se kushtet e punës së deputetëve janë larg nga të qenit të përkryera. Ende na mungon hapësira e nevojshme e zyrave për deputetët dhe gjithashtu nuk ka hapësirë të mjaftueshme as për nevojat e administratës. Që nga viti i kaluar, të gjithë deputetët janë pajisur me laptopë të cilët kanë ndihmuar kryerjen e punëve. Megjithatë, edhe nevojat e administratës po rriten, prandaj shpresojmë se buxheti për periudhën 2008-2010 do të jetë i mjaftueshëm për këtë.

**Çfarë hapash duhet ndërmarrë për të implementuar këtë reformë?**

IK: Hapat e parë për implementimin e kësaj rregulloreje janë të njohur. Zyrtarët përgjegjës dhe udhëheqësi i projektit janë emëruar me miratimin e kësaj rregulloreje. Ne gjithashtu kemi shpallë konkursin për plotësimin e posteve që parashihen nga kjo rregullore. Janë dy poste të cilat aktualisht janë të lira për



shkak disa masave disiplinore dhe më e rëndësishmja është se është shpallë konkursi për administratorët e komisioneve parlamentare. Puna e komisioneve aktualisht nuk është në nivelin e duhur pasi që ende nuk kemi arritur të fitojmë përkushtimin e tyre të plotë që është i nevojshëm për përgatitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve që vijnë nga Qeveria dhe dhënien e rekomandimeve. Rrjedhimisht, kjo reflektohet me vonesa në miratimin e ligjeve. Rregulloret parashohin një afat prej 60 ditësh, mirëpo ai shpesh duhet të vazhdohet për shkak të mungesës së personelit profesional brenda komisioneve.

#### **ASI: Çfarë përkrahje keni nga Kryesia në këtë proces?**

IK: Raportet ndërmjet anëtarëve të Kryesisë (apo Kryesisë si tërësi) dhe Sekretariatit janë duke u zhvilluar në raporte shumë serioze dhe të bashkëpunimit të përditshëm. Dispozitat parashohin që Sekretari të emërohet nga Kryesia dhe t'i japë përgjegjësi asaj. Unë kam pasur një raport të shkëlqyeshëm bashkëpunimi dhe koordinimi me Kryetarin e Kryesisë dhe një raport me të njëjtin intensitet me anëtarët e Kryesisë. Ne zhvillojmë debate për çështje të caktuara, të cilat pastaj marrin formën e përmbajtjes për mbledhjet e Kuvendit që nganjëherë përfundojnë me vendime konkrete në seancat plenare.

#### **ASI: Cilat janë rezultatet e para të kësaj reforme sa u përket detyrave dhe përgjegjësi tuaja?**

IK: Ndër rezultatet e para, do të përmendi dhënien e mundësisë për t'u marrë me disa çështje më profesio-

ale; duke e bërë delegimin e kompetencave te personeli mbështetës ose te drejtorët përmes zinxhirit komandues me udhëheqësit e njërive në kuadër të dy departamenteve. Kjo njëkohësisht, më jep mundësinë që të delegoj kompetenca edhe të ushtrij kontroll mbi mënyrën e zbatimit të kompetencave të deleguara të cilat përfundimisht do të implementohen nga administrata e Kuvendit.

#### **ASI: Çfarë ka qenë reagimi i personelit administrativ ndaj rregullave të reja?**

IK: Pranimi i rregullave të reja është përcjellur me shqetësim. Është thënë se viti 2006 do jetë një vit në të cilin mund të ketë shkurtime të vendeve të punës brenda Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes. Megjithatë, me ndryshimin e Udhëzimit Administrativ mbi Zyrtarët Civil këto shqetësime janë larguar dhe na është dhënë mundësia që të krijojmë vende pune shtesë. Pas konsultimeve të ndryshme me personelin gjatë të cilave kanë marrë pjesë Kryetari, anëtarët e Kryesisë, përfaqësuesit e Projektit për Mbështetje të Kuvendit dhe Konsorciumit, është bërë e qartë se nuk do të ketë shkurtime të vendeve të punës, ndërsa do të ndodhin lëvizje të ndryshme përkritazi me emërimet ose caktimet në poste të reja në përputhje me aftësitë profesionale. Është caktuar një afat prej gjashtë muajsh, brenda të cilit do të bëjmë vlerësimet e punës dhe në bazë të këtyre vlerësimeve do të bëjmë harmonizime dhe rregullime në përputhje me koeficientët ekzistues të pagave.

#### **ASI: Sipas mendimit tuaj, cilat do të jenë prioritetet në**

#### **të ardhmen për të siguruar implementimin e reformës?**

IK: Mendoj se vendimet e ardhshme do t'i përcaktojnë koha. Për momentin do të ketë disa vendime të cilat do të jenë në favor të sigurimit të kushteve dhe mundësive për zyrtarët civil që janë të nevojshme për të qenë shtylla kryesore e Kuvendit për vitet që vijnë. Jemi në një fazë në të cilën kemi një strategji të legjislativit të Kuvendit me 103 ligje. Një numër i ligjeve duhet të përfundohet në afatin prej 120 ditëve pas shpalljes së statusit. Të gjitha këto do të jenë të dobishme dhe do të na ndihmojnë për të marrë vendimet e ardhshme që nevojiten për një funksionalizim më të mirë të administratës, që do të thotë se para nesh është një periudhë shumë sprovue dhe sfiduese. Rezultatet në përfundim të kësaj periudhe do të na japin një koordinatë se në çfarë drejtimi do të merren vendimet e ardhshme që do të manifestohet në reformë, si vazhdim i kësaj reforme të cilën tanimë e kemi filluar.

#### **ASI: Si e shihni personelin tuaj të funksionojë pas tri vitësh?**

IK: Vetë fakti se zyrtarët tanë mund të kenë një pagë shtesë dhe një orar tjetër të punës, do të thotë një fleksibilitet përkritazi me organizmin e punës, më bën të kuptoj se ky personel do të jetë i përkushtuar çdo herë e më shumë ndaj detyrave që u besohen. Kjo është në të mirën e tyre si dhe timen, por ata do të inkurajohen më shumë për të ngritur dhe mëtej nivelin ndaj detyrave që kërkohen nga ta.

#### **ASI: Sipas mendimit tuaj, çfarë mbështetje tjetër ju nevojitet juve personelit tuaj?**

IK: Besoj se Kuvendi ka nevojë për mbështetje në disa fusha. Në radhë të parë, nevojitet të avancohet sistemi i teknologjisë informative. Për momentin, ai është i faktorizuar nga Ministria e Shërbimeve Publike, por ekziston dëshira dhe vullneti që përmes donatorëve dhe përmes projekteve të kemi një teknologji informative të pavarur e cila do të jetë kompatible me atë të Ministrive. Megjithatë, ne duhet të jemi ata që ushtrojnë pavarësi dhe autonomi në përparimin e këtij sistemi. Qëllimi ynë është që të bëjmë funksionalizimin e disa sallave për punën e komisioneve parlamentare, pasi që ato aktualisht nuk kanë kushte të mira për punë, për shkak të mungesës së transkripteve, incizimeve dhe kushteve të nevojshme për debate publike. Mendoj se kjo do të ishte një fushë ku nevojitet mbështetja. Ne kemi zyrën për marrëdhënie me mediat dhe me publikun ku duhet të kemi një avancim si të personelit ashtu edhe në një qasjen kompjuterike; qasja kompjuterike në Kuvend duhet të jetë në dispozicion të çdo qytetari si burim i informatave. Njëkohësisht, ofrimi i qasjes në Kuvendin e Kosovës për qytetarët, shkollat dhe institucionet është një mënyrë tjetër e ofrimit të shërbimeve në interes të popullit të Kosovës. Një mbështetje tjetër mund t'u ofrohet zyrtarëve të ri që parashihet të punësohen në komisionet parlamentare. Trajnimi të tyre nga Konsorciumi do të shtojë njohuritë dhe ngritë kapacitetin e tyre, të cilat mëpastaj do të bartnin tek Kuvendi i Kosovës.

Alfons B. Lentze LLM,  
Mbështetja e Mëtutjeshme për  
Kuvendin e Kosovës

# Konferenca parlamentare në Kosovë mbledhë përfaqësuesit nga 10 kuvende

Kim Vetting, Misioni i OSBE-së në Kosovë

“Ne do të kemi një sektor modern dhe efikas të sigurisë, me mbikëqyrje të fortë parlamentare, me të cilën populli i Kosovës do të krenohet.”

Këto ishin fjalët e Kryeministrit të IPVQ-ve Agim Çeku, gjatë vizitës së pjesëmarrësve të Konferencës Rajonale Parlamentare qeverisë më 19 maj, si pjesë e tri takimeve përfundimtare për institucionet e sigurisë të Kosovës. Konferenca për Mbikëqyrje të Sigurisë përfundoi me fjalët e Komandantit të Forcave të Kosovës (KFOR), Gjeneral Lejtnant Roland Kather, i cili numëroi sfidat e misionit të tij, dhe siguroi pjesëmarrësit që KFOR-i do t'i përmbushë detyrat. KFOR-i kishte organizuar edhe një ndejë në bazën “Film City” dhe iu kishte mundësuar pjesëmarrësve që të takohen me personelin e më shumë se 30 kombeve pjesëmarrëse, gjë që shënoi një përfundim relaksues pas takimeve intensive që u zhvilluan më parë.

‘Konferenca Rajonale për Mbikëqyrje Parlamentare të Sigurisë dhe Sektorit të Sigurisë publike’ është konferenca e tretë rajonale e bashkë-organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës. Konferencat e mëparshme ishin përqendruar në mbikëqyrjen e buxhetit (2005) dhe në mbikëqyrje të policisë (2006). Andaj, kjo ishte konferenca e parë e mbajtur pas themelimit



Komandanti i KFOR-it, Gjeneral Kather, njofton pjesëmarrësit në Qytetin e Filmit

të Komisionit Parlamentar për Siguri në Kosovë, në shtator të vitit 2006, dhe sëkëndejm ka shtjelluar tema dhe sfida të shumta me të cilat është ballafaquar Komisioni. Kështu, përkrahësi i kahmotshëm dhe partneri i OSBE-së në Kosovë në zhvillimin e mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë, DCAF (Kontrolli demokratik i forcave të armatosura me bazë në Gjenevë), gjithashtu kishte qenë bashkë-organizator i konferencës.

Në seancën e hapjes, Kryesuesi i Misionit të OSBE-së, Amb. Werner Wnendt, theksoi që konferenca kishte tri qëllime: të fuqizojë shkathësitë e parlamentarëve që janë të përfshirë në sektorin

e mbikëqyrjes së sigurisë; të përmirësojë mbikëqyrjen e përgjithshme demokratike të sektorit të sigurisë në rajon; dhe të krijojë një raport dhe bashkëpunim më të mirë dhe me parlamentarët e përfshirë në sektorin e sigurisë në tërë rajonin.

“Sektori i sigurisë nuk punon kundër popullit, por duhet të punojë për sigurinë e tyre. Kështu, duhet të bëhet punë e vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve”, theksoi Wnendt.

Katër temat kryesore të diskutuara ishin:

- I) Mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë;
- II) Rregullimidhëmbikëqyrja

e kompanive private të sigurisë;

III) Bashkëpunimi ndërmjet Komisioneve parlamentare për siguri; dhe

IV) Mbikëqyrja e planifikimit dhe përgatitjes emergjente.

Secila seancë ishte kryesuar nga një anëtar i parlamentit nga rajoni, me nga një zëdhënës-raportues nga Kuvendi i Kosovës. Debatet ishin tema të hapura dhe përmbanin nga një folës kryesor që nxitnin debatin. Nëpërmjet lidhjeve me Kuvendin Parlamentar të NATO-s, posaçërisht Komisionit Politik, tre anëtarë dhe drejtori Këshillit kishin marrë pjesë në mënyrë intensive në opinionet e dhëna në zhvilli-

met në rajon. Njëri nga pjesëmarrësit, Senatori Raynell Andreychuk nga Kanada, kryesoi seancën për bashkëpunim rajonal, ku ishin diskutuar disa tema, nga ajo se si të merret pjesë në mënyrë të frytshme në forumet ndër-parlamentare (si OSBE dhe NATO PA), deri tek mënyrat për të tejkaluar pengesat në mbikëqyrjen qeveritare. Megjithatë, pjesëmarrësit kishin filluar diskutimin e mëngjesit për çështjet konkrete; si bëhet mbikëqyrja buxhetore në sektorin e sigurisë, me fjalimin kryesor të paraqitur nga ish-Ministri i Mbrojtjes së Holandës Willem

van Eekelen. Prezantimi i tij shtjelloi tërë ciklin buxhetor, dhe nga ana e pjesëmarrësve, ishte e qartë se Bosnja dhe Hercegovina kishte krijuar një mënyrë të mirë të punës.

Një temë tjetër konkrete ishte mbikëqyrja e Kompanive Private të Sigurimit, një pikë e cila është duke u bërë ligj për momentin në Kosovë, në grupin punues në kuadër të Ministrisë e Punëve të Brendshme. Dr Michael Von Tangen Page kishte theksuar elementet të cilat duhet të adresohen në legjislacionin, duke dhënë shembuj të rajonit, ku legjislacioni nuk

ka qenë adekuat dhe kishte nevojë për ligje ndihmëse. Në Kosovë, Komisioni për Siguri kishte formuar një nën-grup punues, të trajnuar nga Misioni i OSBE-së, i cili përcjell kontrollin e kompanive private të sigurisë në mënyrë më intensive.

Seancat e pasdites, përfshinë fjalimin e folësit kryesor Z. Maloku mbi përvojat që kishte në lidhje me mbikëqyrjen e kapaciteteve të IPVQ-ve për t'u përgatitur për emergjenca, projekt ky i përkrahur nga OSBE-ja që përfshinte hulumtimet e kryera nga Instituti Kosovar për Hulumtime Pub-

like (KIPRED) si dhe të dhënat nga raportuesi i Kuvendit të Kosovës, me vërejtjet përmblylëse nga drejtori i Departamentit për Qeverisje të mirë dhe Institucione Demokratike pranë OSBE-së, Znja. Wilma Theuws, dhe nga koordinatori i Iniciativës për Përkrahje Kuvendit, Z Franklin Devrieze.

Ishte e para herë që Kosova kishte qenë nikoqire e një konference me një pjesëmarrje të gjerë nga rajoni, dhe duke iu referuar vlerësimeve të pjesëmarrësve, me gjasë që kjo konferencë kjo nuk do të jetë e fundit.



*Kryetari i Komisionit për siguri, Z. Maloku, Kryesuesi i OMIK-ut, Ambasadori Wnendt dhe përfaqësuesi nga DCAF, Z. Wim van Eekelen gjatë hapjes së sesionit në Hotel Grand*



# Grupi joformal parlamentar i grave në Kuvendin e Kosovës

*Një faktorë i ri apo vetëm një sfidë e përkohshme në skenën aktuale politike të Kosovës*

*Intervistë me Znj. Gjylshene Berisha (LDK) dhe znj. Hatixhe Hoxha (PDK), bashkë-kryesuese e grupi joformal parlamentar të grave në Kuvendin e Kosovës.*



**Gjylshene Berisha**

Iniciativa për krijimin e Grupi Joformal Parlamentar të grave daton që nga legjislacioni i parë i Kuvendit të Kosovës, por është realizuar vetëm disa vite më vonë pas konsultimeve të shumta me deputetët dhe kryesuesit e grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës. Deputetët gra janë mbledhur për të promovuar agjendën e tyre të përbashkët për përmirësimin e pozitës së grave në shoqërinë e Kosovës.

Ky grup është themeluar më 5 korrik 2005 dhe korrespondon me vizitën e z. Medlin Ollbrajt në Kosovë – ish Sekretare e Shtetit të SHBA-ve. Një grup i tillë shumë partiak dhe shumë etnik ku qeveria dhe opozita, komunitetet shumicë dhe pakicë punojnë së bashku

në objektiva të përbashkëta, paraqet një rast unik për Kuvendin e Kosovës.

**ASI: A mundeni ju lutem të përshkruani strukturën aktuale të Grupit Joformal Parlamentar të Grave?**

Gjylshene Berisha: Grupi ynë përbëhet nga 36 anëtarë dhe një bordi drejtues prej 8 anëtarësh, që pasqyron formulën e Kryesisë së Kuvendit: dy anëtarë nga LDK-ja, dy nga PDK-ja, një nga AAK-ja, ORA dhe 6+, dhe një anëtare nga komuniteti serb i Kosovës. Aktivitetet e Grupit Joformal Parlamentar të grave udhëhiqen nga dy bashkë-kryesuese në baza alternimi, një nga shumica dhe një nga opozita me mandat një vjeçar.

**ASI: Cilat janë objektivat e grupit tuaj?**

Hatixhe Hoxha: Objektivat tona korrespondojnë me këto çështje: fuqizimin e grave në politikë dhe vendim-marrje; monitorimin e implementimit të Ligjit për Barazi Gjinore, të Drejtat e Njeriut dhe ligjet relevante për barazi gjinore, fuqizimin e pozitës së gruas në shoqëri, arsim, kulturë dhe ekonomi; bashkëpunimi mes grave parlamentare dhe shoqërisë civile dhe grave tjera parlamentare në rajon.

**ASI: Cila sipas jush është arritja më e madhe e grave parlamentare në Kuvendin e Kosovës?**

Hatixhe Hoxha: Mendoj që initiative për përpilimin e Ligjit për Barazi Gjinore si dhe amendamenti i ligjeve

tjera (p.sh ligji për pushimin e lehonisë) paraqesin disa prej të arriturave më të rëndësishme.

**ASI: Cilat ishin aktivitetet kryesore të grave të grupit joformal parlamentar për këtë vit?**

Gjylshene Berisha: Anëtarët e Grupi Joformal Parlamentar të Grave kanë marrë pjesë në disa ngjarje ndërkombëtare në Zagreb dhe Sarajevë të organizuara nga Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore. Grupi Joformal Parlamentar është pranuar si anëtar i barabartë i grupeve parlamentare nga EJL. Pastaj, Grupi Joformal Parlamentar i grave gjithashtu me sukses ka organizuar disa tryeza të rrumbullakëta në Prishtinë në lidhje me arsimin, çështjet sociale dhe problemet shëndetësore në Kosovë si dhe



**Hatixhe Hoxha**

tryezën e rrumbullakët për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Anëtarët e Grupit rregullisht kanë organizuar vizita në terren me qëllim të mbledhjes së të dhënave dhe shkëmbimit të informacionit me popullatën e Kosovës, posaçërisht grupet e grave nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Gratë parlamentare nga Kuvendi i Kosovës ishin grupi i parë i parlamentarëve që për herë të parë vizitoi shkollën e mesme lokale.

Muajin e kaluar në bashkëpunim me OSBE-në ne kemi organizuar një konferencë rajonale të grave parlamentare me qëllim të fuqizimit të marrëdhënieve tona me homologet tona në parlamentet fqinje. Dua të përmend edhe një gjë: grupi i grave parlamentare nga Kuvendi i Kosovës janë nënshkruese të Memorandumit Ndërkombëtar kundër Trafikimit me qenie njerëzore të nënshkruar më 8 mars 2006 në Bernë të Zvicrës.

#### *ASI: Por ju nuk jeni filluar nga zeroja apo jo?*

Gjylshene Berisha: Jo. Bordi i kaluar është udhëhequr nga z. Sanije Zeqiri dhe Flora Brovina, që ka zhvilluar një numër aktiviteteve përkundër vështirësive me të cilat po ballafaqohet Grupi Joformal Parlamentar i grave. Aso kohe, grupi ka zhvilluar strategjinë, vizionin dhe misionin. Sipas këtij dokumenti, Grupi Joformal Parlamentar i Grave do të punojë për përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje në Kuvendin e Kosovës dhe në të gjitha institucionet tjera të Kosovës. Misioni i këtij grupi përkon pjesërisht me përpjekjet për të përmirësuar gjendjen aktuale në nivelin lokal ku nuk ka gra

në postin e Kryetarit të Kuvendit Komunal apo të Kryeshefit Ekzekutiv. Pjesëtarët e Grupi Joformal Parlamentar janë të përkushtuara të përfaqësojnë zërin e të gjitha grave në institucionet e Kosovës dhe sëkëndejmi të ndërtojnë kapacitetet e strukturave demokratike në Kosovë për të siguruar pjesëmarrjen e grave në të gjitha sferat e pjesë publike dhe vendim-marrje.

#### *ASI: Cilat janë planet e juaja për të ardhmen?*

Hatixhe Hoxha: Ne me kujdes kemi vlerësuar angazhimin tonë për disa vitet e ardhshme dhe mbi këtë bazë, kemi përcaktuar prioritetet tona për të siguruar fuqizimin e mëturjes së grave në strukturat vendim-marrëse dhe institucionet e Kosovës, kontributin në draftimin dhe zbatimin e Ligjit për Zgjedhjet, procesin kushtetues dhe Ligjin për Partitë Politike. Kemi planifikuar gjithashtu takime të shumta me institucionet udhëheqëse të Kosovës: Presidentin, Kryeministrin dhe Kryetarin e Kosovës, Kryetarët e Partive politike dhe kryesuesit e grupeve parlamentare, si dhe akterët kryesor të mediave dhe shoqërisë civile në Kosovë. Ne me padurim presim të koordinojmë aktivitetet tona me Zyrën e Kryeministrit/Agjencinë për Barazinë Gjinore, Rrjetin e Grupeve të Grave, UNIFEM, UNDP, dhe Paktin e Stabilitetit për EJL. Do të doja të shprehja mirënjohjen tonë për partnerët dhe përkrahësit tanë, p.sh Misionin e OSBE-së në Kosovë, NDI, Zyrat Ndërlidhëse të Zvicrës, Holandës, Suedisë dhe Belgjikës.

*Bujar Maxhuni,  
Misioni i OSBE-së në Kosovë*

## **Anëtarët e Grupit Joformal Parlamentar të Grave në Kuvendin e Kosovës**

### **LDK**

Nekibe Kelmendi  
Melihate Termkolli  
Sanije Aliaj  
Samije Zeqiraj  
Remzije Nimani  
Zyrije Maloku  
Nurishhe Hulaj  
Gjylshen Berisha  
Nafije Berisha  
Brikenda Kryeziu  
Besa Gaxherri  
Naxhije Doçi  
Rudina Bukoshi  
Lumnije Hyseni  
Qibrije Hoxha

### **PDK**

Flora Brovina  
Nerxhivane Dauti  
Teuta hadri  
Sala Ahmeti  
Drita Statovci  
Sala Shala Berisha  
Safete Hadergjonaj  
Selvije halimi  
Zahrije Jusufi  
Hatixhe Hoxha

### **AAK**

Gjylnaze Sylja  
Zylfije Hundozi  
Myrvete Dreshaj

### **VAKAT**

Shpresa Murati

### **ORA**

Teuta Sahatqija  
Fatmire Kollqaku

### **GIS**

Zlatica Kujundzic

### **KDTP**

Nuran Malta

### **SLKM**

Snezana Milic  
Vesna Jovanovic

### **GIG**

Vezira Emrush

# Deputetët dëgjojnë zërin e qytetarëve

Arben Kelmendi, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)



Gjylnaze Sylja

Në një sistem funksional demokratik, përfaqësuesit e zgjedhur përmbushin obligimet e tyre ndaj qytetarëve. Organizimi i zgjedhjeve të lira vë gurthemelet e një shoqërie demokratike, por nuk garanton përfaqësim të denjë të interesave të qytetarëve. Përfaqësuesit e zgjedhur duhet të vendosin mekanizma për komunikim të rregullt me qytetarët, në mënyrë që qytetari të sigurohet se zëri i tij dëgjohet. Parlamentet që dështojnë në ushtrimin e funksionimit të tyre përfaqësues, shkaktojnë ngritje të pakënaqësisë të qytetarët dhe humbje të përkrahjes së tyre për sistemin "demokratik".

Deputetët mbajnë kontakte të rregullta me zgjedhësit e tyre. Një ndër mënyrat më të popullarizuara dhe më efikase për këtë është hapja e zyrave të posaçme që kanë për synim

përmirësimin e komunikimit me qytetarë në zonat e tyre zgjedhore.

Vitin e fundit janë vërejtur iniciativa të ngjashme për hapjen e zyrave të tilla nga disa deputetë, përkundër mungesës së përkrahjes institucionale.

Deputetja Gjylnaze Sylja nga AAK-ja është pioniere e këtyre iniciativave. Zyra e saj për komunikim me qytetarë ekziston tanimë një vjet e gjysmë dhe siç shprehet ajo: "Ditën kur e kam hapur zyrën, jam ndjerë vërtetë si përfaqësuese e popullit...ka pasur shumë raste kur qytetarët ishin të vetëdijsëm se jo gjithmonë ne mund t'i ndihmojmë në zgjidhjen e hallit të tyre, por thjeshtë kishin nevojë për dikë që t'i dëgjojë".

Hajredin Hyseni, deputet i PDK-së, është rasti më i freskët i hapjes së një zyre të tillë.

200 qytetarë të qytetit të Podujevës ishin prezentë gjatë ceremonisë së hapjes. "Qytetarët ishin kureshtarë të dinin se çfarë shërbimesh mund të ofrojë zyra e deputetit dhe kohën kur mund të më takojnë" deklaroi deputeti Hyseni.

I pranishëm gjatë ceremonisë ishte edhe deputeti Fehmi Mujota, nga e njëjta parti, i cili e ndihmonte kolegun e tij më të ri me këshilla dhe shembuj të shumtë nga përvoja e tij e ngjashme në Shtime. "Unë jam sot këtu që t'i ofroj përkrahje morale kolegut tim dhe që sado pak t'ia bart përvojën time në këtë drejtim", thotë deputeti Mujota me plot modesti.

Deputeti tjetër nga PDK, z.Bajrush Xhemajli, për dy muaj me radhë takoi qytetarët ferizajas në zyrën e tij, dhe pranoi se disa informata që i ka mblodhi nga qytetarët i kanë shërbyer gjatë përgatitjes

së pyetjeve parlamentare për ministrat. Shembuj janë pyetjet që kanë të bëjnë me ndërtime e rrugës së Jezercit, rasti i pacientëve ferizajas të cilët për hemodializë janë të detyruar të udhëtojnë çdo javë në Gjilan si dhe pyetja rreth masave të sigurisë përgjatë hekurudhës e cila kalon nëpër qendër të Ferizajit. Këto janë vetëm disa shembuj se si deputeti mund të shfrytëzojë informatat nga qytetarët për t'i bërë qeveritarët më të përgjegjshëm dhe të adresojnë shqetësimet e qytetarëve.

Zyra të njëjta kanë hapur edhe deputetët e qytetit të Gjakovës si dhe Berat Luzha në qytezën e Kaçanikut. Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë kuptuar se me ndryshimet në sistemin zgjedhor, adoptimin e listave e hapura të kandidatëve dhe kontaktet e rregullta me qytetarë kanë rëndësi të jashtëzakonshme.



Bajrush Xhemajli



# Procesi Kushtetues

Nekibe Kelmendi, deputete e Kuvendit të Kosovës, LDK



Pas dorëzimit të propozimit të Presidentit Ahtissari, unë isha anëtare e grupit të ekspertëve të Grupit Politik dhe Strategjik, të angazhuar nga Ekipi i Unitetit. Ky Grup filloi menjëherë me hartimin e Materialit Kushtetues (Kushtetuta joformale) me qëllim të lehtësimit të punës së Këshillit Kushtetues të sapoformuar në hartimin e Draft Kushtetutës së Kosovës dhe përshpejtimit të procesit të hartimit të këtij dokumenti më të lartë juridik për Kosovën pas definimit të statusit të saj politik.

Fillimisht, u themeluan disa nëngrupe për qëllime të hartimit të kapitujve kushtetues. Në këtë mënyrë, produkti i të gjitha këtyre grupeve do të inkorporohej në një material të veçantë kushtetues.

Porsa të kryhej inkorporimi i këtyre produkteve në Materialin Kushtetues, grupi vazhonte punën e vet në harmonizimin dhe sistematizimin e produkteve dhe eliminimin e elementeve (të mundshme) që përsëriten. Ky grup punues

po ashtu hartoi edhe Ligjin Kushtetues për të Drejtat e Komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, i cili u është shpërndarë të gjithë anëtarëve të këtij grupi dhe disa anëtarëve të Ekipit të Unitetit.

I tërë Materiali Kushtetues, për të cilin u deshën muaj për t'u përgatitur, tani do të bartet tek Këshilli Kushtetues i themeluar kohëve të fundit, me qëllim që atyre t'u ofrohet mundësia që të ndërhyjnë aty ku është e nevojshme dhe ta kompletojnë atë para se Kushtetuta të procedohet në Kuvendin e Kosovës për miratim.

Draft Rregullorja mbi Punën e Këshilli Kushtetues për Hartimin e Kushtetutës u hartua paralelisht me këto dy dokumente të tjera, ndërsa USAID-i/OSBE-ja kanë punuar në hartimin e një plani për të vetëdijesuar publikun lidhur me Kushtetutën e Kosovës, e cila si edhe dokumentet e lartpërmendura, është një plan joformal. Këshilli Kushtetues duhet të punojnë në të gjitha këto materiale dhe të dorëzojnë

përmbajtjen përfundimtare, ndërsa Kushtetuta do të bëhet publike, ashtu që çdo qytetar i Kosovës të jetë i informuar mbi përmbajtjen e Kushtetutës së ardhshme të Kosovës.

Është mendim i imi personal se gjatë periudhës së tranzicionit që duhet të fillojë pas miratimit të rezolutës së re për Kosovën, institucionet e Kosovës, së bashku me gjithë ekspertët e vet kombëtarë dhe ndërkombëtarë, do të jenë në gjendje t'i përmbushin të gjitha detyrat që dalin nga propozimi i Presidentit Ahtisaari për hartimin e Kushtetutës dhe të ligjeve. Kjo do të thotë se ato do të finalizohen me kohë për t'i marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë që duhet të transferohen nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Në 17 muajt e fundit, procesi ka marrë shumë kohë, përpjekje dhe energji, që nga fillimi i procesit të negociatave të ndërmarrë me mbështetjen ndërkombëtare, siç është Presidenti Ahtisaari dhe Grupi i UNOSEK-ut, për përfundimin e këtyre dokumenteve.

Nuk duhet të harrohet angazhimi i organizatave ndërkombëtare të vendosura në Kosovë, mes tyre i USAID-it, dhe OSBE-së, Grupit të Kontaktit, Zyrave Ndërlidhëse, dhe një numri të ekspertëve amerikanë dhe ekspertëve nga vendet fqinje. Ndihma e tyre çmohet shumë nga institucionet, ekspertët dhe populli i Kosovës. Ndihtesë që iu ofrua atyre ishte e natyrës financiare dhe profesionale,

përmes organizimit të simpoziumeve dhe konferencave jashtë vendit, ku kanë marrë pjesë pjesëtarët e të gjitha komuniteteve pakicë, dhe kanë dhënë ndihmesë të madhe në përgatitjen e Materialit Kushtetues.

Kur flasim për Materialin Kushtetues të përfunduar nga grupi përkatës, me lejon të saktësoj se hartimi i këtij materiali nuk ka qenë aspak punë e lehtë, pasi që Kushtetuta e Kosovës, sikur Statusi i Kosovës, do të jenë sui generis dhe nuk mund të konsiderohen precedent nga asnjë vend tjetër në botë. Një pikë e veçantë e Materialit Kushtetues është ajo se ai përmban dispozita që mundësojnë diskriminim pozitiv, që është një shmangie pozitive nga standardet dhe kushtetutat ndërkombëtare sa u përket komuniteteve pakicë dhe pjesëtarëve të tyre. Megjithatë, duhet të vihet në dukje se Konventa Evropiane për Mbrojtje të Pakicave i emërton komunitetet si 'pakica', dhe parashtron një grup të ndryshëm të drejtash.

Tani populli i Kosovës është plotësisht i vetëdijshëm që pa marrë parasysh gjakun e atyre që e dhanë jetën për çlirimin e Kosovës dhe të drejtës së vet për vetëvendosje, ata po zotohen edhe për një sakrificë tjetër; diskriminim pozitiv dhe lehtësirat tjera për komunitetet pakicë. Me ndihmën e Zotit, kjo po bëhet që të arrihet objektivi shekullor i integritetit të saj Euro-Atlantik.

# Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve viziton komunitetet në të gjitha Komunat e Kosovës

Intervistë me z. Randel Nojkic (SLKM), Kryetar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Sanije Alijaj (LDK), nënkryetare e Komisionit.



Sanije Alijaj

**ASI: Më herët Komisioni për Komunitete kishte vështirësi, tani gjërat duken të jenë më mirë. Cilat janë arsytet për këtë progres pozitiv?**

R. Nojkic: Unë nuk do të pajtohesha me konstatimin që situata në Komision ka ndryshuar. Unë i kam shkruar Kryetarit të Kuvendit në emër të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat Komuniteteve lidhur me disa çështje dhe Kryesia nuk e pa të arsyeshme të përgjigjet. Për rrjedhojë, unë ia adresova letrën pastaj PSSP-së dhe akoma po pres për përgjigjen e tij. Unë kam të drejtë që të marrë një përgjigje nga Kryesia e Kuvendit dhe në këtë rast mendoj se ka shkelje të procedurave.

S. Alijaj: Më parë, Komisioni ka përjetuar disa vështirësi. Ekzistojnë disa vonesa në përmbylljen e planit të punës, duke pasur parasysh që të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me

interesat e komuniteteve janë shqyrtuar me Këshillin Konsultativ për Komunitete. Tani kemi një përjasje pozitive, ku Komisioni fton përfaqësues të Ministrisë si në takime të rregullta ashtu edhe gjatë vizitave në terren. Në fund të tetorit, OSBE-ja ka filluar projektin e ri për rritjen e efikasitetit të punës së Komisionit. Plani përqendrohet në katër pika: shtimi i aktiviteteve të bashkëpunimit mes Komisionit dhe Ministrisë për Kthim; vizitë pune për Komisionin në Dhjetor, vizita pune në komunat e Kosovës, dhe tryeza të rumbullakëta me palë të interesit vendor dhe ndërkombëtarë të cilët merren me Komunitete. Të gjitha këto janë realizuar deri tani dhe ne do të vazhdojmë kështu edhe gjatë vitit 2007.

**ASI: Komisioni juaj ka përgatitur një plan për vitin 2007. Cilat janë sfidat e këtij**

**plani?**

R. Nojkic: Çdo projekt ligj që arrin në Komision me kohë hyn si pjesë e agjendës dhe diskutohet. Në këtë plan, ne kemi paraparë vizita në terren të cilat janë të rëndësishme për punën tonë. Në disa raste ne nuk kemi arritur ti organizojmë ato si duhet sepse Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk i ka dërguar përfaqësuesit e saj në këto vizita. Shpresoj të realizojmë gjithë çfarë kemi paraparë me Plan. Por nuk mendoj që do të vazhdojmë të merremi me çështjet që janë ngritur nga komunitetet gjatë vizitave tona në terren. Për arsye ngaqë Komisioni ka të drejta të kufizuara dhe që Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk po i përcjell dhe nuk po merr pjesë në këto vizita në terren. Si Komisioni ne i kemi parashtruar kërkesë Ministrisë që të na informojë për buxhetin e Ministrisë për vitin 2006 dhe planin për alokimin e mjeteve buxhetore për vitin 2007. Akoma nuk kemi marrë një përgjigje nga Ministria për Komunitete dhe Kthim sa i përket buxhetit.

S. Alijaj: Komisioni ka miratuar Planin e Punës për vitin 2007. Ky plan është përgatitur në bashkëpunim me Koordinatorin e OSBE-së. Do të theksoja që deri më sot asnjë nga amendamentet e projektligjeve që gjenden në procedurë prekin interesat e komuniteteve.

Anëtarët e Komisionit do të mbikëqyrin zbatimin e ligjeve

të miratuara nëse ato po implementohen si duhet dhe me efikasitet. Komisioni do të ketë një rol aktiv në miratimin e projektligjeve gjatë periudhës tranzitore prej 120 ditëve pas miratimit të Planit të Ahtisarit nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Komisioni për Komunitete do të përqendrohet kryesisht në Ligjet që kanë të bëjnë me jetët, të drejtat dhe liritë e komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

**ASI: Çfarë janë marrëdhëniet e juaja me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim? Çfarë është bashkëpunimi juaj me Ministrin e ri?**

R. Nojkic: Besoj që përgjigja ime që dhashë më lartë ofron një sqarim të mjaftueshëm për marrëdhëniet tona me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

S. Alijaj: Komisioni ishte vazhdimisht i gatshëm për të ofruar bashkëpunimin e vet për të gjithë, përfshirë këtu edhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, me qëllim të zgjidhjes së çështjeve që u ngritën gjatë vizitave në terren dhe në Komision. Tani për tani, Komisioni ka marrëdhënie të mira me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, dhe me Ministrinë e Pushkëtisë Lokale dhe Administratës. Natyrisht, gjithmonë ekzistojnë nevoja e vazhdueshme për një koordinim më të mirë të punës.



Randel Nojkić

**ASI: Komisioni juaj ka organizuar vizita në terren nëpër disa komuna; cili është rezultati nga këto vizita?**

R. Nojkić: Rezultati i këtyre vizitave nuk është edhe aq i kënaqshëm. Për shembull, gjatë vizitës sonë në Ferizaj, një prej anëtarëve të Komisionit që ishte përgjegjës për ndërmjetësimin e çështjeve të caktuara mes Komisionit, Ministrisë dhe Komuniteteve që takuam atje nuk erdhi në takimet e rregullta të Komisionit dhe as që ndërmoi gjë në lidhje me shqetësimet që u ngritën nga komunitetet që vizituam. Prandaj edhe nuk mund të pohojmë të kemi bërë një punë të mirë. Besoj që rregullimi i punës së Kuvendit do të përmbajë dhe ofrojë masat për ata që nuk i përmbushin kushtet e punës së tyre. Për momentin, nuk ka masa të tilla, dhe puna e anëtarëve të Komisionit bazohet vetëm në vullnetin e tyre të lirë. Anëtarët e Komisionit që kanë vullnetin për të punuar janë aktiv, ndërsa atyre që u mungon vullneti janë pasivë. Dhe për një gjë të tillë nuk

ekziston ndonjë sanksionim.

S. Alijaj: Po ne kemi vizituar disa Kuvende Komunale dhe kemi parë që pushtetet lokale po punojnë në integrimin e komuniteteve dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre. Përkundër punës së mëtutjeshme që nevojitet për të mirën e të gjithë qytetarëve, ekzistojnë disa rezultate inkurajuese. Me këtë rast, do të doja të përmend Komunën e Dragashit ku 43% të pushtetit lokal është i përbërë nga komunitetet lokale dhe pothuajse të gjitha projektet e donatorëve janë të koncentruara në lokacionet e banuara me këto komunitete. Në Ferizaj, të gjitha shtëpitë e serbëve që jetojnë në Bablak dhe Babushë janë të rindërtuara dhe presin kthimin e pronarëve në to. Kryetari i Novo Bërdës është gjithashtu serb, dhe ndonëse banon në një komunë me një shkallë të ultë të zhvillimit ekonomik ai deklaroi që fjala 'diskriminim' nuk zë vend atje. Komisioni gjithashtu informon Ministrinë për Komunitete dhe Kthim për të gjitha shqetësimet e qytetarëve..

**ASI: Si një ndër Komisionet kryesore të Kuvendit të Kosovës, Komisioni juaj shqyrton çdo ligj që kalon nëpër Kuvend. Cilat janë sfidat kryesore të Komisionit gjatë shqyrtimit të Ligjeve?**

R. Nojkić: Po ky është një ndër komisionet kryesor. Por kur ne ngritëm çështjen e projektligjit për Numrat Personal, i cili është kthyer nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, ligji sërisht është kthyer në Kuvend dhe është miratuar më pas. Kjo tregon që ndonëse zyrtarisht është një prej komisioneve kryesore, në praktikë nuk ngjanë asisoj. Sa i përket shqyrtimit të ligjeve, Komisioni gjithmonë ka vepruar me kohë dhe kurrë nuk ka vonuar në shqyrtime. Ka raste kur anëtarët e Komisionit nuk pajtohen, por kjo është gjë normale që shfaqet gjatë shqyrtimit të ligjeve nga Komisioni. Mendoj që çështja sesi t'u qasemi dhe t'i zgjedhim situatat e caktuara kur ka probleme nuk është e rregulluar si duhet. Komuniteti serb ka vërejtje për Planin e Ahtisarit, ngaqë parashihet ekzistimin e mekanizmave të ngjashme me këto që tanimë ekzistojnë e që nuk kanë dhënë rezultate të kënaqshme. Sikur të rregulloheshin këto mekanizma, jam i sigurt që Komisioni do të kishte më pak probleme. Gjatë vizitës sonë në Belgjikë, ne kemi parë që komunitetet atje gëzojnë të drejta të barabarta, përfshirë këtu edhe komunitetin gjerman i cili përbën 3-5% të popullatës. Atje komunitetet vendosin mbi atë se çfarë është e pranueshme për ta. Ky parim do të duhej të zbatohet edhe në Kosovë.

S. Alijaj: Gjatë disa takimeve të fundit kemi patur atmos-

ferë me mungesë tolerance në mesin e anëtarëve duke i rezistuar kthimit apo kishte përpjekje për të vonuar procedurat e miratimit të amendamenteve të projektligjeve të caktuara pas leximit të dytë me arsyetimin që Kosova nuk ka status të njohur ndërkombëtarisht. Kjo bie ndeshë me rregulloren e Kuvendit dhe në asnjë mënyrë nuk janë prekur interesat e komuniteteve. Prandaj ne bëjmë një marrëveshje mes anëtarëve të Komisionit për të që projektligjet para se të procedohen në Kuvend, posaçërisht ato që dalin nga Plani i Ahtisarit të shqyrtohen para se të kalojnë në leximin e parë. Në këtë mënyrë procesi i miratimit do të lehtësohet dhe Komisioni do të ketë më shumë kohë për të shqyrtuar ligjet.

**ASI: A keni diçka për të shtuar?**

R. Nojkić: Mendoj që OSBE-ja duhet të organizojë më shumë takime dhe tryeza të rumbullakëta ku mund të marrin pjesë njerëzit dhe anëtarët e komuniteteve që kanë mendime të ndryshme. Ky është problem me të gjitha organizatat ndërkombëtare në Kosovë, meqë ato bisedojnë ndaras me shqiptarët dhe ndaras me serbët, dhe një praktikë e tillë nuk i ndihmon zgjidhjes së problemeve ndëretnike.

S. Alijaj: Dua vetëm të theksojë që jam krenarë që bëj pjesë në këtë Komision të rëndësishëm dhe që kontributi im në këtë Komision është që të sigurohem që komunitetet që jetojnë në Kosovë të gëzojnë të drejta të barabarta

Elita Vokshi, O  
Misioni i OSBE-së në Kosovë



# Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë si vegël e luftimit të korrupsionit

*Në bazë të ligjit kundër korrupsionit, të gjithë zyrtarët e lartë janë të obliguar të deklarojnë pasurinë e tyre*

*Intervistë me Z. Hasan Preteni, Drejtor i Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit*

**ASI: Çfarë nënkupton deklarimi i pasurive?**

Hasan Preteni: Deklarimi i pasurive është instrument i veçantë i luftimit dhe i parandalimit të korrupsionit, i paraparë me Ligjin Kundër Korrupsionit (LKK), të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 22 prill 2005 dhe i shpallur nga PSSP-ja me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/26. Përmes këtij procesi të gjithë zyrtarët e lartë (siç thuhet në nenin 2 të LKK-së) janë të obliguar të japin informacionet lidhur me pasurinë e tyre. Ndër të tjera, ata do t'u nënshtrohen hetimeve sa i përket ekzistimit të konfliktit të interesave, si dhe parandalimit të mundësisë për të shtuar pasuritë e tyre në mënyrë të paligjshme.

**ASI: Çfarë parasheh ligji për këtë?**

HP: Mbikëqyrja e pasurive është e rregulluar me LKK-në, i cili specifikon mënyrën dhe formën e deklarimit të pasurive të zyrtarëve të lartë publikë, fushë kjo e rregulluar në Kreun e 5-të të këtij Ligji. Në nenin 39 të këtij Ligji, mes tjerash, thuhet se: Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit mbikëqyrë pasurinë e personit të lartë zyrtar në bazë të informacionit të dorëzuar nga personi i lartë zyrtar në një formularë të posaçëm, i cili përcaktohet nga Agjensioni.

Brenda një muaji nga marrja e postit, personi i lartë zyrtar



i vë në dispozicion të Agjencisë informacionin e mëposhtëm, siç është funksioni i cili kryhet si profesionist apo si jo-profesionist, funksione ose aktivitete të tjera që kryhen nga personi zyrtar, funksionet e kryera nga personi zyrtar në periudhën më të afërt para marrjes së postit, gjendjen e pasurive të tij ose të personave që janë në marrëdhënie të afërt me të

**ASI: Çka duhet të deklarojnë zyrtarët e lartë?**

HP: Informacioni në lidhje me gjendjen e pasurive të personit të lartë zyrtar ose të personave që janë në marrëdhënie të afërt me personin zyrtar të lartë përmban informacione rreth pasurive dhe të ardhurave të tyre, si më poshtë: patundshmëri, pasuri e luajtshme në vlerë të madhe, zotërimi nga ana e tyre i aksioneve në shoqëri komerciale, letra me vlerë,

para të gatshme të mbajtura në bankë, banka kursimesh dhe institucione të tjera kursumi apo kreditore, borxhet, garancitë e ndërmarrja dhe detyrimet e tjera, dhe të hyrat vjetore (që shërbejnë si bazë e tatueshme). Sipas LKK-së, pasuri e luajtshme në vlerë të madhe konsiderohen pasuritë e luajtshme me vlerë mbi 5.000 €. Agjencia mund të kërkojë dëshmi për informacionin e paraqitur në formularin e deklarimit të pasurive. Çdo ndryshim në gjendjen e pasurive të zyrtarit duhet të raportohet nga personi i lartë zyrtar në Agjenci. Agjencia gjithashtu mund të kërkojë në çdo kohë nga personi i lartë zyrtar që të dorëzojë informacionin lidhur me të dhënat e përmendura më lart. Personi i lartë zyrtar duhet të përmbushë kërkesat e Agjencisë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e kërkesës.

**ASI: Cilët zyrtarë janë të obliguar të deklarojnë pasurinë e tyre?**

HP: Sipas Ligjit Kundër Korrupsionit (LKK), Agjencia mbikëqyrë pasuritë e 'personave të lartë zyrtarë'. Në nenin 2 të LKK-së me person të lartë zyrtar nënkuptohet: Presidenti i Kosovës, Kryeministri, Kryetarin dhe deputetët e zgjedhur të Kuvendit dhe Kryetari i tij, ministrat, sekretarët e qeverisë, sekretarët e përhershëm, drejtorët e zyrave në kuadër të ministrive, gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe zyrtarët e lartë ndërkombëtarë.

**ASI: Çka ndodh kur zyrtarët e lartë nuk dorëzojnë formularin për deklarimin të pasurisë? A mund të ndërmerret ndonjë sanksion?**

HP: Nëse personi i lartë zyrtar nuk dorëzon informacionin brenda afateve të parapara me LKK (31 mars), Agjencia nxjerr një paralajmërim dhe vendos një afat të ri i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e nxjerrjes së paralajmërimit. Po ashtu, nëse personi i lartë zyrtar nuk dorëzon informacionin e kërkuar as gjatë këtij afati, Agjencia informon organin ku personi i lartë zyrtar ushtron detyrën e tij ose organin përgjegjës për përcaktimin e pagesës së pagës ose shpërblimit e pagës. Në këtë rast, paga ose shpërblimi i pagës zvogëlohen me një të pestën (1/5) për çdo muaj, derisa nga Agjencia të merret

informacioni kërkuar.

Nëse personi i lartë zyrtar nuk e dorëzon informacionin e kërkuar brenda tre (3) muajve, Agjencia njofton organin përgjegjës për fillimin e procedurës për shkarkimin nga detyra. Pagesa e pagës ose shpërblimi i pagës ndërpritet.

**ASI: Deri në çmasë ishte i suksesshëm deklarimi i pasurive?**

HP:Procesi i deklarimit të pasurive ka qenë i suksesshëm pasi që deri me 4 maj 2007, nga 732 zyrtarë të lartë që kanë qenë të obliguar të bëjnë deklarimin e pasurisë, 94.4% e tyre e kanë përmbushur këtë obligim ligjor. Duhet të theksohet se edhe pse ky afat kishte kaluar, ky proces është në vazhdim e sipër, që do të thotë që Agjencia ka pranuar më shumë formularë pas skadimit të këtij afati.

**ASI: Çfarë mund të thoni lidhur me konfidencialitetin e këtyre deklarimeve?**

HP:Sipas LKK-së, të gjithë personat të cilët janë pjesë e Agjencisë: anëtarët e Këshillit të Agjencisë dhe çdo person i punësuar nga Agjencia janë të detyruar të ruajnë si sekret zyrtar çdo informacion të marrë nga Agjencia gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Çështja e konfidencialitetit më hollësisht është e rregulluar me nenet 44, 45 dhe 46 të LKK-së. Përveç tjerash, formularët e dorëzuar duhet t'i nënshtrohen një hetimi të gjithanshëm me qëllim të verifikimit të vërtetësisë së të dhënave dhe të pasurisë së deklaruar, si dhe të ekzistimit të konfliktit të interesave.

Lodewijk Vanoost,  
Misioni i OSBE-së në Kosovë

## Kthimi i goranëve në Kosovë është me rëndësi jetike

Intervistë me znj. Vezira Emruš (GIG) – anëtarja më e re e Kuvendit të Kosovës



Në këtë intervistë, Znj. Vezira Emrus, si anëtarja më e re e Kuvendit të Kosovës, diskuton gjendjen e femrës në Kosovë, komunitetin goran, procesin e kthimit si dhe pikëvështrimin e saj mbi Planin e Ahtisarit.

**ASI: Znj. Emruš, si e shihni rolin aktual të gruas në politikën kosovare, duke patur parasysh tradicionalizmin e shoqërisë kosovare?**

Vezira Emruš: Roli i femrës në gjitha komunitetet është i vështirë sot në Kosovë. Gruaja, e sidomos gratë e komunitetit goran, janë rritur dhe akoma rriten në një mentalitet patriarkal; ato janë shtylla e familjes por nuk mund të dalin në pah plotësisht. Kur një femër e re bëhet 18-19 vjeç, ajo frenohet nga familja e saj dhe dekurohet në vazhdimin e arsimit. Por, në qytete gjendja është ndryshe. Unë për shembull jam lindur më 1954, por kam pasur mundësinë e arsimit formal. Konsideroj pozitën time si shumë përgjegjëse, dhe përfaqësoj jo vetëm gruan gorane, por secilën grua në Kosovë.

**ASI: Cilët janë qëllimet politike të Iniciativës Qytetare Gorane?**

VE: Ne jemi komunitet i vogël, dhe gjithmonë kemi pasur qëllime identike me ato të vendit në të cilin kemi jetuar. Jemi shumë të interesuar për procesin e integritimit evropian, përmirësimin e gjendjes eko-

nomike në Kosovë, jetesë më të mirë, integrim rajonal dhe kyçje në rrjete pune.

**ASI: Pasi jeni përfaqësuese në Kuvendin e Kosovës, cilat janë, për mendimin tuaj, sfidat kryesore për komunitetin goran në këtë periudhë?**

VE: Jemi shumë të brengosur. Komuniteti shumicë nuk është unik. Pse? Komuniteti ynë goran në Dragash është i përçarë në komunitete boshnjake e gorane. Kështu, disa akterë politikë mundohen të ndajnë komunitetet pakicë, për t'i bërë ato subjekte më të dobëta në skenën politike. E njëjta gjë ndodhë edhe me komunitetin shqiptar, dhe ne gjithashtu shpresojmë që të arrijnë unitetin për të trajtuar me efektivitet sfidat e ballafaquara tek komunitetet e vogla. Kjo do t'i ndihmonte integrimin brenda shoqërisë kosovare, si dhe integrimin rajonal.

**ASI: A jeni të kënaqur me vendin që "komunitetet tjera" kanë brenda shoqërisë aktuale në Kosovë?**

VE: Për të qenë e sinqertë, nuk jam e kënaqur. Kemi një kuotë të caktuar, të siguruar, dhe kur vie tek zgjedhjet, komuniteti ynë përçahet e manipulohet nga shumë akterë politikë. Sa i përket ligjeve elektorale, kemi siguruar një vend në Kuvend. Edhe pse ka pasur më parë një prag zgjedhor prej 0.5% (të gjithë elektoratit kosovar), tani ka një prirje që kjo të ndryshojë e të rritet deri në 2, 3 ose 4%, gjë që nuk do t'i mundësonte komuniteteve të vogla, e as partive të vogla shqiptare, të hyjnë në Kuvend. Besojmë që nuk jemi të për-

faqësuar në mënyrë adekuate, si dhe mendoj që është e nevojshme të bëhen veprime e miratohen ligje të favorshme për komunitetet e vogla, për të na mundësuar të marrim pjesë në vendimet me të cilat ballafaqohet sot Kosova.

**ASI: Ju gjithashtu jeni anëtare e Grupit Parlamentar për Integrim. Për mendimin tuaj, cilat janë sfidat madhore për integrimin e komuniteteve pakicë brenda shoqërisë kosovare?**

VE: Më së pari, komuniteti ynë goran është tejet i shpërndarë. Një pjesë e madhe e tyre jetojnë jashtë Kosovës – në Serbi, Mal të Zi, Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci e shumë tjerë jetojnë në vendet e Evropës Perëndimore. Ky është problem i pandarë i komunitetit tonë. Do të shfrytëzoja këtë rast të apeloj tek Qeveria e Kosovës për të inkurajuar investimet në rajonin e Gorës, si dhe të krijojë një fond zhvillimi për të inkurajuar njerëzit të qëndrojnë aty.

**ASI: Dhe sa i përket procesit të kthimit?**

VE: Procesi i kthimit është çështje e mbijetesës sonë. Askush nuk mund të përcaktojë pozitivisht statusin sasior të komunitetit tonë, pasi njerëzit vazhdimisht migrojnë. E di që në vitin 1999 kishte mes 13,000 dhe 17,000 goranë që jetonin në gjithë Kosovën, Dragash, Pejë, Prishtinë dhe Prizren, dhe tani kanë mbetur vetëm rreth 3-4,000. Komuniteti është shumë i shpërndarë, dhe çështja e kthimit është me rëndësi jetike për ne.

**ASI: Çka mendoni se duhet bërë për të inkurajuar anëtarët e komunitetit goran që të kthehen?**

VE: Veçanërisht, duhet të ketë më shumë investime në infrastrukturën e fshatrave të Gorës. Duhet të ketë investime në vendbanimet tona për të krijuar një ekonomi të shëndoshë, e cila pastaj do të inkurajonte kthimin; perspektiva e punësimit dhe shtëpitë janë të nevojshme për të inkurajuar kthimet. Tutje, do të theksoja nevojën për komuna gorane. Ju e dini që një nga elementet më të rëndësishme të Planit të Ahtisarit është decentralizimi. Komuniteti ynë kishte komunën e vet qysh më 1931, të quajtur "Komuna e Gorës". Më vonë, më 1968, ishte transformuar në Komunën e Dragashit. Sot është shumë-etnike dhe ka komunitete shqiptare, gorane dhe boshnjake që jetojnë aty. Komuna është çështja më e rëndësishme në lidhje me procesin e kthimit, pasi jo vetëm që njerëzit i besojnë më shumë organeve të tyre, por më së shumti do të ndërtonte besimin e njerëzve. Do të mundësonte edhe punësim shtesë, si dhe do të mundësonte kontakte më të mira me zyrtarë.

**ASI: A do të përmirësojë Plani i Ahtisarit gjendjen e komuniteteve pakicë, dhe në çfarë mase mendoni se do të ketë ndikim në to?**

VE: Sa i përket Planit të Ahtisarit, ai nuk definon secilin komunitet të veçantë; ato nuk janë analizuar. Plani i përshtatet komunitetin tonë, ndërsa ne gjejmë një aspekt

pozitiv – procesin e decentralizimit. Kosova ka sipërfaqe të ngjashme me Slloveninë, dhe ka afërsisht popullsi të njëjtë. Sot, Sllovenia ka 240 komuna, derisa Kosova ka vetëm 30. Shumicës së komunitetit shqiptar i përshtatet kjo, dhe kjo ka mbetur kështu. Plani i Ahtisarit ofron një mundësi të krijimit të mundësive të reja me 5,000 banorë apo 75% të popullsisë shumicë në zonën gjeografike, dhe ne kemi gjitha mundësitë për një njësi të tillë. Nëse arrijmë këtë, goranët do të jenë përgjegjës dhe në krye të ekzistencës së tyre në Kosovë; ata do të ballafaqoheshin me gjendjen ekonomike dhe politike vetë. Përveç kësaj, ekziston edhe çështja e gjuhës. Ne jemi të vetëdijshëm që në Kosovë, përveç shqipes, edhe serbishtja është gjuhë zyrtare. Ne nuk duam të akuzohemi për përdorim të plan-programeve të Beogradit, si dhe kërkojmë nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Arsimit që pas tetë vitesh të hartojë plan-programin në gjuhën serbe, të cilin do ta shfrytëzojmë që t'i ofrojmë fëmijëve tanë arsim të duhur. Është shumë me rëndësi që fëmijët tanë të mund të vazhdojnë arsimin e tyre në Serbi, Bosnjë e Hercegovinë e Maqedoni.

**ASI: Ndonjë porosi për lexuesit tanë?**

VE: Po. Shiko, kam një moto jetësore: Secili duhet ta dojë vetveten për t'i dashur tjerët.

*Intervistë nga Mario Maglov, Koordinator i Qendrave Informative të Komunitetit, DPI-UNMIK në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë.*



## Një vështrim në punën e Kuvendit

*Liia Hänni, Këshilltare e lartë e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Misioni i OSBE-së në Kosovë*



Kur erdha në Kosovë ishte një dimër i ftohtë. Për një person që vjen nga shtetet Nordike siç jam unë ishte lehtësim kur m'pashë se dimrat në Kosovë mund të jenë mjaft të ftohtë dhe me dëborë. Thashë vetë me vete, 'ndoshta nuk është shumë vështirë që të kuptojë njerëzit në Kosovë dhe përfaqësuesit e tyre në Kuvend'. Lufta për mbijetese me forcat e natyrës dhe superfuqitë politike të cilat e kanë formësuar shoqërinë Kosovare janë mjaft të ngjashme me ato që Estonia i ka kaluar gjatë historisë së saj. Sidoqoftë tani vera pothuajse ka arritur, dhe ka ardhur koha që unë të bëjë një përmbledhje të disa vështrimeve të mia pas punës në Kuvend.

Kuvendi i Kosovës është një institucion unik. Pas shprehjes së vullnetit të lirë të popullit të Kosovës në zgjedhje, Kuvendi i Kosovës ende nuk ka kompetenca për të ushtruar disa detyra të zakonshme të cilat përbëjnë mandatin e një parlamenti të pavarur. Ky nuk është një rol i lehtë dhe duhet t'i besohet maturisë politike të deputetëve dhe grupeve politike në Kuvend për të mos i ngutur shumë ngjarjet. Por është po ashtu e rrezikshme vetëm të pritët deri në zgjid-

hjen e statusit. Jeta në Kosovë duhet të vazhdojë, dhe Kuvendi, në cilësinë e pushtetit ligjvënës, ka një rol të rëndësishëm që duhet ta luajë për këtë qëllim.

Agjenda e punës legislative për vitin 2007 e miratuar nga Kuvendi është shumë ambicioze. Ajo përmban më tepër se njëqind ligje. Përveç kësaj, duhet të përgatiten dhe miratohen në ndërkohë edhe Kushtetuta e Kosovës dhe projektligjet e nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes mbi Statusin. Deri më tani, vetëm shtatë ligje nga lista janë miratuar nga Kuvendi, prandaj edhe nuk është me reale të pritët që të gjitha punët e planifikuara të kryhen gjatë pjesës së mbetur të vitit. Prandaj, ekziston nevoja për të shqyrtuar një plan të ri legjislativ të veprimit për Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës në mënyrë që të tejkalohen sfidat për këtë periudhë të mbetur kohore.

Edhe pse Kosova ka nevojë për ligje të reja në shumë fusha, duhet të ketë një marrëveshje për listën e ligjeve me prioritet sa më shpejtë që është e mundur. Plani i veprimit duhet të theksojë afatet për dorëzimin e projektligjeve në Kuvend, procedurat dhe departamentet qeveritare të cilat janë përgjegjëse për përgatitjen e projektligjeve. Ngjashëm me agjendën legislative për vitin 2007, komisioni udhëheqës për projektligjet përkatëse duhet të caktohet paraprakisht. Kjo do t'u jepte mandat komisioneve të kuvendit që të përshpejtojnë procesin e hartimit në mënyrë që të sigurojnë respektimin e afateve dhe arrijten e cilësive së duhur të ligjeve. Do të ishte e dobishme sikur të arrihet

marrëveshje me Qeverinë për t'u mundësuar përfaqësuesve të komisioneve përkatëse (raportuesve të ardhshëm) pjesëmarrje në takime të grupeve punuese të hartimit të ligjeve. Kjo ofron një mekanizëm i cili vazhdimisht do t'i informojë komisionet mbi përparimin e punës dhe do t'i jep mundësi grupit punues për hartim që të konsultohet me komisionin udhëheqës mbi aspekte të rëndësishme të ligjit.

Gjithashtu ekziston edhe nevoja për të rishqyrtuar procedurat legislative në Kuvend. Praktikata e tanishme, në të cilat komisionet kryesore funksionale zyrtarisht përfshihen vetëm pas leximit të parë, duken si të vjetruara. Në realitet një numër i komisioneve fillojnë të punojnë në projektligje gjatë një periudhe të mëhershme. Mundësia për përfshirje më të hershme të komisioneve është e paraparë edhe në Rregulloren e Kuvendit ku rregulli 35.7 thotë: "Komisioni funksional apo udhëheqës, në parim mund të shqyrtoj projektligjin edhe para leximit të parë të projektligjit në sesionin plenar".

Arsyeja për këtë, është që kur një projektligj futet në rend të ditës nga Kuvendi, ai mund të fillojë të shqyrtohet menjëherë nga komisionet përkatëse. Jorastësisht, komisionet quhen edhe truri i parlamentit pasi që ato kanë mundësi të analizojnë përbërjen e projektligjeve në një atmosferë apolitike e cila karakterizohet me debate plenare. Rekomandimet nga komisionet parlamentare i sigurojnë Kuvendit mundësinë e informimit para marrjes së vendimeve të tyre për të miratuar apo jo projektligjin

në leximin e parë. Nuk mendoj se të gjithë janë të kënaqur me faktin që Kuvendi duhet të votojë një projektligj menjëherë pas procedurave të leximit të parë. Kjo është një periudhë mjaft e madhe kohore e cila e zvogëlon efikasitetin e punës së Kuvendit. Në bisedimet që i kam pasur me kryesuesit e komisioneve ata tregojnë qëndrimet e tyre pozitive drejt përfshirjes së hershme të komisioneve në këtë proces. Në mënyrë që kjo të ndodhë, nuk ka nevojë që të ndryshohet Rregullorja e Kuvendit por krejt çka duhet të bëjmë është që të fillojmë zbatimin universal të rregullit 35.7. Kryesia e Kuvendit pastaj ka të drejtë të plotë që të bëjë marrëveshje praktike për të rregulluar punën e Sekretariatit dhe sesioneve plenare në agjendën e punës së procedurave legislative.

Edhe pse versioni i tanishëm i Rregullores është fleksibil drejt organizimit më të mirë të punës së Kuvendit, duket se është e nevojshme që atij t'i bëhen analiza komplekse. Miratimi i Rregullores së korrigjuar do të ishte një trashëgimi e lënë me vend dhe e mençur nga ky Kuvend për Kuvendin e ri. Ekziston një burim i mirë i cili mund të shfrytëzohet – përvoja e përbërjes së tanishme të Kuvendit. Është koha të ri-themelohet një komision ad hoc për Rregulloren në mënyrë që të ndërmarr mbi vete këtë punë të rëndësishme dhe të bëjë përgatitjet e nevojshme për kuvendin tjetër. Jam e sigurt që partnerët ndërkombëtar të cilët punojnë në mbështetje të Kuvendit janë të gatshëm që të japin kontributin e tyre në këtë aspekt.

# Përshtypjet për Kuvendin e Kosovës nga një ish-Parlamentare

Në shikim të parë, jeta në Kuvendin e Kosovës, kur Kuvendi mban seancë plenare, duket të mos ketë ndonjë ndryshim të madh nga jeta në Dhomën e Përfaqësuesve në Parliament Hill në Kanada. Para fillimit të seancës, deputetët mbledhen në korridoret e Kuvendit, përshëndeten, pinë kafe dhe shkëmbejnë fjalë të mira. Vetura të zeza BMVV rreshtohen në parking para Kuvendit. Sigurimi është kudo prezent, bashkë me përfaqësuesit e mediave, me kamerat dhe diktafonët e tyre në dorë, duke pritur mundësinë për të marrë deklaratat. Të gjitha këto shenja tregojnë arritjen e pashmangshme të Kryeministrit në Kuvend. Vërehet një ndjenjë nervoze. Në fakt, kur arrin Kryeministri, edhe ai gjen kohën edhe për t'u ulur në bar, të përshëndetet e të flasë me deputetët para fillimit të seancës. Qetësi para stuhisë.

Seanca e javës së kaluar mblodhi jo vetëm Kryeministrin, por gjithë Kabinetin e tij – një pamje shumë impulsive, edhe pse e rrallë, në seancat plenare të Kuvendit. Arsyeja e kësaj pjesëmarrjeje të "yjeve" të të gjithë kabinetit u bë e ditur në shqyrtimin e Rendit të Ditës së seancës plenare. Pika e parë e rendit të ditës së mërkurë ishte interpelanca e Kryeministrit Agim Çeku, që ishte kërkuar nga Grupi Parlamentar i ORA-s, ndërsa pika e radhës, pas leximit të parë të katër projekt-ligjeve, ishte shqyrtimi i Raportit Vjetor të punës së Qeverisë për vitin 2006. Megjithatë, deri të enjten pasdite, e të premtën në mëngjes, numri i ministrave të pranishëm ishte zvogëluar në shtatë, ndërsa të hënën në mëngjes, kishin mbetur vetëm katër ministra në Kuvend. Në fakt, të premtën pasdite, kur debati mbi Rininë e Kosovës ishte shtyrë për në seancën e së hënës në mëngjes, Ministri i Kulturës, Rinisë e Sporteve foli para Kuvendit për t'iu thënë deputetëve që ai nuk kishte mundësi të merrte pjesë në seancën e së hënës, por që mirëpret mundësinë e diskutimit në ndonjë seancë tjetër.

Ajo që është shumë e habitshme për seancat plenare është që Kuvendi është plot me anëtarë, si dhe atë jo vetëm gjatë "Kohës për Pyetje Parlamentare", ose gjatë interpelancave. Derisa seancat plenare të Kuvendit zakonisht mbahen dy herë në muaj, shumë deputetë kanë pozita tjera ose janë të punësuar jashtë Kuvendit. Por, Rregullat Procedurale i mundësojnë deputetëve kompensim shtesë për pjesëmarrje në seancat plenare të Kuvendit, si dhe për punën e tyre në Komisionet e Kuvendit.

Por, puna e vërtetë e Kuvendit bëhet kur Kuvendi nuk është në seancë, edhe pse gumëzhima që vërehet në hyrje të Kuvendit në ditët e seancave plenare mund të mos vërehet në një ditë të zakonshme pune. Megjithatë, për çdo ditë mund të shihen deputetë në Kuvend që mbajnë një mori dokumentesh dhe që vrapojnë prej një takimi në tjetrin. Gjithë deputetët marrin pjesë

në së paku një Komision, si dhe në nën-Komisione. Edhe pjesëmarrja e deputetëve në takime të Komisioneve është shumë impulsive. Ndonëse Rregullat Procedurale i kërkojnë Komisioneve të takohen, sipas nevojës, së paku një herë në dy javë pune, vërehet që disa Komisione takohen shumë më shpesh se kaq.

Në takime me një numër Kryesuesish të Komisioneve dhe nën-kryesuesish, si dhe në një numër dëgjimesh të Komisioneve, duke përfshirë edhe ato publike, nuk mund të mos impresionohem me barrën e punës që deputetët bëjnë në Komisione, por edhe më shumë me faktin që deputetët realisht kryejnë gjithë punët vetë. Ka shumë pak resurse për Komisionet. Mungojnë ekspertët për t'i ndihmuar Komisionet në punën e tyre. Në Dhomën e Përfaqësuesve, në secilin Komision caktohet një Nëpunës dhe së paku një apo dy hulumtues nga Biblioteka e Parlamentit. Përveç tyre, Komisionet mund të shfrytëzojnë edhe shërbimet e personelit ekspert, profesional, teknik dhe sekretarial nëse i konsiderojnë të nevojshme.

Në Kosovë, Kryesuesit e Komisioneve janë plotësisht pa personel. Megjithatë, deputetët që kryesojnë një Komision kanë fatin më të mirë. Së paku kanë një zyrë dhe një telefon. Shumica e deputetëve nuk kanë zyra; këta deputetë duhet të mjaftohen me zyrat e Grupit të tyre Parlamentar për të mbajtur takime. Pesëdhjetë deputetë të LDK-së ndajnë një zyrë, derisa 30 deputetë të PDK-së ndajnë një zyrë tjetër. Nuk ka nevojë të përmendet ndoshta që Kuvendi nuk i siguron anëtarëve Buxhetin vjetor Operacional të Deputetit (BOD).

Pjesa e mrekullueshme e të qenit deputet është pjesëmarrja në dëgjimet publike të Komisionit. Kamerat xhirojnë; mediat dhe diktafonët e tyre janë gjithkrah. Është mundësia e fotografimit e dëgjimit, mundësi të cilën anëtarët e Komisionit nuk mund ta anashkalojnë për dobinë e tyre. Si në Kanada, dëgjimet publike të Komisioneve në Kosovë i lejojnë dëshmitarëve që të qortojnë një Ministër apo Ministri për mosplotësimin e obligimeve të tyre, duke mos anashkaluar faktin që ky lloj i paraqitjes mund të mos jetë taktika më e mirë e dëshmitarëve nëse me të vërtetë dëshirojnë të shtyjnë punët e tyre përpara.

Derisa dëgjimet publike shërbejnë për të lehtësuar shqyrtimin legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe transparencën, këto dëgjime japin edhe mundësinë për anëtarët e Komisionit që t'u 'hakmerren' Ministrave që nuk i përfillin komisionet. Në një takim publik mbi kinematografinë në Kosovë, një anëtar Komisioni falënderoi dëshmitarët që kishin ftuar Ministrin të marrë pjesë në takimin e Komisionit, pasi vetë Komisioni nuk kishte qenë në gjendje të sigurojë pjesëmarrjen e Ministrit para Komisionit.



Megjithatë, komenti i këtij anëtar nuk është anomali. Shumë anëtarë komisionesh ankohen që Ministrat nuk marrin pjesë në takimet e tyre kur ftohen. Deri më sot, nuk duket të ketë ndonjë pasojë për ata Ministra që anashkalojnë dhe injorojnë komisionet.

Megjithatë, sfida më e madhe e Komisioneve dhe anëtarëve individualë të Komisioneve është pranimi i projekt-ligjeve që janë tepër të dobëta, e të cilat kanë më shumë nevojë për amendamente sesa që përmbajnë nene në projekt-ligj. Problemi ndërlikohet më shumë nga fakti që nuk ka ndonjë mostër standarde për një projekt-ligj. Ndryshe nga Urdhëresat në Fuqi të Dhomës së Përfaqësuesve në Kanada, Rregullat Procedurale të Kuvendit të Kosovës nuk parashikojnë që "projekt-ligji nuk mund të paraqitet në formë të zbrazët apo të pakryer".

Përveç ndjekjes së seancave të Kuvendit dhe takimeve të Komisionit, deputetët kanë edhe takimet e Grupeve të tyre Parlamentare. Megjithatë, shumica e këtyre takimeve mbahen një ditë para seancës plenare të Kuvendit, e edhe në ditën e seancës plenare, nëse ka nevojë. Nuk ka ndonjë dispozitë në Rregullat Procedurale për t'i mundësuar Grupeve Parlamentare që të takohen rregullisht, ose në një kohë të caktuar. Në Dhomën e Përfaqësuesve në Kanada, gjitha grupet parlamentare të partive takohen rregullisht, zakonisht të mërkurave në mëngjes, kur Parlamenti është në seancë. Të mërkurave, për shkak të taki-

meve të këtyre Grupeve, Dhoma e Përfaqësuesve nuk mban seanca para orës 14:00.

Secili grup parlamentar duket që zgjedhë Shefin e Grupit Parlamentar gjegjësisht. Megjithatë, këta shefa të grupeve jo vetëm që janë udhëheqës të grupit të partisë së tyre, por shërbejnë edhe si udhëheqës Dhome dhe shefa të grupit të tyre parlamentar. Vijimisht, këtyre udhëheqësve iu duhet një zyrë dhe një ndihmës, të cilët sigurohen nga Kuvendi.

Deputetet gjithashtu kanë një grup shtesë parlamentare që duhet ta ndjekin. Derisa nuk janë të pranuar si grup zyrtar parlamentar, deputetet janë organizuar vetë në një Grup Joformal të Deputeteve (GJD), i cili përbëhet nga anëtarët femra të Kuvendit, nga të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. GJD-ja udhëhiqet nga dy bashkë-kryesues, një bashkë-kryesues nga partitë në koalicionin qeveritar, si dhe tjetra nga partitë e opozitës. Mandati i GJD-së është të trajtojë nevojat dhe brengat e femrës në shoqërinë kosovare. Në fakt, GJD-ja është grupi i dytë më i madh parlamentar në Kuvend.

Një nga çështjet kryesore që trajtohen nga GJD-ja është të sigurojë që ligji i ri zgjedhor të ruajë një të tretën e ulëseve në Kuvend për femrat, në sistem me lista të hapura. Javën e kaluar, anëtarët e GJD-së u takuan me Fatmir Sejdiun, Presidentin e Kosovës, për të kërkuar mbështetjen e tij për këtë çështje, si dhe paraqiten një listë rekomandimesh, të cilat theksojnë nevojën e përfshirjes së femrës në gjitha nivelet e qeverisjes.

Pra, derisa nuk ka seancë plenare në Kuvend këtë javë, dhe ndoshta një ecje në korridoret e Kuvendit nuk mund të kërkojë shumë siguri, media, shumë deputetë, ministra e ndoshta edhe vetë Kryeministrin, deputetët ende mund të shihen duke vrapuar nga një takim në tjetrin, si dhe duke kryer punët që i kanë marrë përsipër, me mundësitë e tyre të kufizuara. Si ish-deputet, unë vetëm mund t'i admirojë dhe t'u duartrokasë gjithë deputetëve për gjithë përkushtimin e tyre ndaj shërbimit publik, si dhe barrës së madhe të punëve që ata kryejnë.

7 qershor 2007

*Përgatitur nga i Nderuari Sarmite D. Bulte, P.C.*

*"Semi" ka shërbyer si Anëtar Parlamenti në Dhomën Kanadeze të Përfaqësuesve nga viti 1997 deri më 2006, si dhe ka mbajtur një numër pozitash, si Kryesues i Grupit Liberal të Ontarios, Kryesues i Komisionit të Përhershëm të Trashëgimisë Kanadeze, Kryesues i Nën-Komisionit për Tregtinë Ndërkombëtare, Kontestet Tregtare dhe Investimet, Sekretar Parlamenti tek Ministri i Trashëgimisë Kanadeze, si dhe Sekretar Parlamentar tek Ministria e Industrisë (me theks të veçantë në ndërmarrëset femra).*



# Duke u fokusuar në mjedis

Blerim Vela, Misioni i OSBE-së në Kosovë



## 1. Bashkimi Evropian (BE) dhe Mjedisi

Që në fillim të marrjes së detyrës, Jose Manuel Barroso, Kryetari i Komisionit Evropian bëri krahasimin e tri preokupimeve kryesore të BE-së - ekonominë, solidaritetin social dhe mjedisin – me tre fëmijët e tij. “Nëse njëri fëmijë është i sëmurë, ju lëni çdo gjë anash që të kujdeseni për ta,” shpjegoi ai. “ por kjo nuk do të thotë që të tjerët i doni më pak.”

Në atë kohë për Barrosin, ekonomia ishte fëmija më i sëmurë në familje. Në ndërkohë, vëmendja e Barrosos u kthye kah mjedisi, çështje të cilën e kanë pranuar madje edhe ndihmësit e tij, që ai e kishte parë si pengesë për vende pune dhe zhvillim. Kryetari i Komisionit Evropian e pranon që i kishte marrë ca kohë të bënte lidhjen ndërmjet

shpëtimin të planetit dhe agjendës së mirëfilltë për ekonomi, veç kësaj tani është i bindur që këto dy agjenda e plotësojnë njëra tjetrën

## 2. Prioriteti mjedisor i Kosovës

Në prill të vitit 2006, Plani Mjedisor për Veprim i Kosovës 2006-2010 është miratuar si pjesë e Programit Qeveritar. Është dokumenti i parë i këtyre i hartuar në Kosovë, që ka për

synim përmirësimin gradual të gjendjes së mjedisit dhe me këtë rast edhe përmirësimin e shëndetit publik në përgjithësi. Plani Mjedisor për Veprim i Kosovës për 5 vitet e ardhshme do të jetë korniza kryesore për të gjitha aktivitetet që do të ndërmerren me qëllim të përmirësimit gradual dhe mbrojtjes në Kosovë, ku duhet të bazohen të gjitha aktivitetet prioritare të institucioneve përkatëse në nivelin komunal dhe qendror të lidhura me mjedisin.

Megjithatë, vitet e ardhshme do të jenë vite sfiduese për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë. Është një nevojë e ngutshme për ngritje të zhvillimit ekonomik, e cila sipas disave bën që çështjet mjedisore të lihen anash. I këtyre është toni i debateve të tanishme për termocentralin me thëngjill të Kosovës C. Institucionet e Kosovës, duke

i vendosur strukturat e tyre me organet e nevojshme duhet të tregojnë gatishmëri për shtjellimin e problemeve kyçe të mjedisit. Pritet që brenda këtyre viteve të kompletohet legjislacioni mjedisor me ligje suplementare. Në të njëjtën kohë, mjedisi duhet të shfrytëzohet më shumë për avancimin e premisave demokratike (pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje, qasje në informata dhe drejtësi) të përfshira brenda tij.. Në fund, mjedisi është pronë e të gjithëve dhe nuk njihet kufij. Veç kësaj, është gjëja e vetme që e posedojmë dhe si i tillë është standard që duhet ta plotësojmë në mënyrë që të kemi të ardhme.

## 3. Legjislacioni mjedisor

Më 16 janar, 2003 në Kuvendin e Kosovës ka kaluar Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit. Ky ligj ka për qëllim të përmirësojë mjedisin dhe shëndetin e popullit të Kosovës duke paraqitur gradualisht standardet mjedisore të Bashkimit Evropian. Ligji përcakton përgjegjësitë e agjencive të ndryshme publike, dhe autorizon krijimin e Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (KEPA), që duhet të themelohet brenda 18 muajve. Sipas këtij ligji, Qeveria duhet të zhvillojë Strategjinë për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Mjedisit dhe gjithashtu duhet të paraqes Raport Mjedisor çdo dy vjet. Është arritur shumë, por disa dispozita të ligjit, 4 vite pas miratimit akoma nuk janë zbatuar në tërësi. Shihet qartë që ka tendencë për të iu adresuar çështjeve mjedisore

sipas sektorëve, duke mos e marrë parasysh atë të përgjithshmen.

Legjislacioni mjedisor ka paraqitur disa parime të Konventës Aarhus, duke përfshirë parimin “Ndotësi paguan” dhe të drejtën e qytetarëve për tu informuar mbi cilësinë e mjedisit të tyre. Ligjet e reja obligojnë vlerësimet e ndikimeve në mjedis, masat mbrojtëse për mjedisin, rregullat për mbeturinat e rrezikshme dhe disa rregulla për atë se kush është përgjegjës për ndotjen e mjedisit.

## 4. Sfidat

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit ekzistojnë dy sfida kyçe me të cilat përballet Kosova. E para do të jetë përmbyshja e afatit kohor për krijimin e planeve dhe themelimin e agjencive nga Kuvendi. Veç kësaj, duhet të ketë prioritete të qarta të politikave, të cilat i drejtojnë veprimet e Ministrisë. Sfidat e dytë me radhë do të jetë implementimi dhe zbatimi i ligjeve mjedisore si dhe politikave në mënyrë kuptimplotë. Komisioni Parlamentar për Çështje Mjedisore duhet të vazhdojë me inspektimin e punës së Ministrisë dhe të sigurojë që ligjet mjedisore dhe politikat të implementohen plotësisht. Populli i Kosovës meriton një mjedis të pastër dhe të shëndoshë, por legjislacioni mjedisor i mbron ata aq mirë sa edhe zbatimi i tij. Pa financimin adekuat për KEPAn dhe nismat tjera mjedisore, çështjet mjedisore do të jenë plotësisht të dështuara.

# Angazhimi i asistentëve të përkohshëm: Një hap Drejt forcimit të rolit të komisioneve

Rinor Beka – Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)



Komisionet parlamentare luajnë rol të rëndësishëm në procesin legjislativ përmes shqyrtimit në hollësi të projektligjeve, organizimit të dëgjimeve publike dhe mbikëqyrjes së ministrive dhe zbatimit të ligjeve. Disa komisione mbulojnë aktivitetet e dy apo më shumë ministrive gjë që kërkon profesionalizëm dhe koordinim adekuat të aktiviteteve nga ana e personelit mbështetës të komisioneve.

Duke marrë parasysh këtë gjendje, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), në bashkëpunim me kryetarët e komisioneve të Kuvendit të Kosovës, para disa muajsh vendosi të angazhojë për kohë të shkurtër, gjashtë asistentë që do të mbështesin punën e katër komisioneve partnere të NDI-së. Asistentët që nga fillimi janë përfshirë në kryerjen e detyrave të përditshme administrative të Komisionit si, organizimi i dëgjimeve publike, organizimi i vizitave në teren dhe çështjeve tjera procedurale. Meqenëse, Kuvendi i Kosovës nuk disponon me një qendër për zhvillimin e hulumtimeve, një pjesë e rëndësishme e punës së tyre

është edhe zhvillimi i hulumtimeve legjislative.

Angazhimi i asistentëve ka pasur për qëllim arritjen e tri synimeve kryesore në përpjekje për të përmirësuar cilësinë e punës në Komision: inicimin e procesit të përpilimit të planeve vjetore të punës, kryerjen e hulumtimeve rreth përputhjes së akteve nënligjore me ligjet bazë që janë miratuar në Kuvend dhe ndryshimi dhe plotësimi i bazës së të dhënave të komisionit për OJQ-të dhe ekspertët.

## Planet vjetore të punës për Komisione

Në bashkëpunim me kryetarët e komisioneve dhe personelin mbështetës, asistentët kanë hartuar planet vjetore të punës të mbështetura kryesisht në agjendat legjislative të ministrive. Këto plane reflektojnë rendin kronologjik të projek-

tligjeve që do të shqyrtohen nga komisioni, mbajtjen e dëgjimeve publike, zhvillimin e vizitave në teren dhe raportimin e ministrive dhe zyrtarëve qeveritarë rreth punës së tyre.

Planet vjetore të punës janë shqyrtuar nga komisionet si pikë e veçantë dhe së bashku me ndryshimet e propozuara nga deputetët janë miratuar si një dokument zyrtar në bazë të së cilit do të zhvillohen veprimtaritë në Komision. Iniciativën e Institutit Kombëtar Demokratik NDI e kanë ndjekur edhe komisionet tjera të Kuvendit të cilat me ndihmën e OSBE dhe AER kanë krijuar planet vjetore të punës. Hartimi i planeve të punës është pritur shumë mirë nga ana e deputetëve ndërsa këtë nismë e ka mbështetur edhe Kryetarit të Kuvendit. Së fundi planet e punës janë publikuar dhe janë vënë në dispozicion

të deputetëve dhe opinionit publik.

## Përputhja e legjislacionit sekondar me ligjet themelore të miratuara nga Kuvendi

Përveç miratimit të ligjeve, një pjesë shumë e rëndësishme e punës së Kuvendit është edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve nga ana e Qeverisë. Asistentët e angazhuar nga NDI mbështesin punën e Komisionit në këtë aspekt duke zhvilluar hulumtime rreth përputhshmërisë së akteve nënligjore të nxjerra nga ministrinë dhe institucionet tjera me ligjet themelore të miratuara nga Kuvendi. Disa nga hulumtimet e zhvilluara kanë zbuluar zbrazëtira në përputhjen e akteve nënligjore me ligjet bazë. Rezultatet e hulumtimeve kanë bërë që Komisionet të thërrasin në



dëgjime zyrtarët ligjor të ministrive përkatëse për të kërkuar llogari dhe shpjegime rreth mospërputhjeve, duke forcuar kështu edhe më tej funksionin mbikëqyrës të komisioneve.

### Ndryshimi dhe plotësimi i bazës së të dhënave për komisionet

Komisionet parlamentare vazhdimisht organizojnë dëgjime publike me qëllim të grumbullimit të informacioneve dhe përfshirjes së opinionit publik të cilët do të jenë përfitues apo të dëmtuar nga projektligjet që shqyrtohen në Komision. Në këtë drejtim, asistentët janë angazhuar në plotësimin dhe kategorizimin e bazës së të dhënave për OJQ-të dhe ekspertët të cilët do të ftohen nga Komisioni për të marrë pjesë në dëgjimet publike varësisht nga natyra e çështjeve që rregullohen me projektligjin në shqyrtim. Disa nga komisionet tanimë kanë në dispozicion listat me emrat dhe informatat kontaktuese për shumë organizata, institucione, sindikata dhe ekspertë të pavarur të cilët do të shfrytëzohen në përpjekje për të përmirësuar cilësinë e dëgjimeve publike.


Me përgatitjen e tyre të lartë arsimore dhe përvojën para-prake, asistentët e angazhuar në komisione janë treguar efikas në përmbushjen e detyrave dhe kontributi i tyre është vlerësuar lartë nga kryetarët e komisioneve dhe personeli mbështetës. Komisionet parlamentare vazhdojnë të mbajnë mbi supë barrën më të madhe të punës në Kuvendin e Kosovës dhe mbështetja e vazhdueshme për të është e nevojshme për përmirësimin e cilësisë së punës në këtë institucion.

## Ndikimi i Planit të Standardeve të Kuvendit

Më 1 qershor 2006, Kryeparlamentari Kolë Berisha prezantoi Planin e Standardeve të Kuvendit. Kjo pako e reformave kishte për qëllim ushtrimin më të mirë të mbikëqyrjes ekzekutive nëpërmjet Periudhës së rregullt të Pyetjes dhe seancave të interpelancës dhe ishte e mirëseardhur nga të gjithë grupet parlamentare.

Në 12 muajt e parë, pas prezantimit të parë të Planit të Standardeve, janë parashtruar 140 pyetje dhe janë mbajtur 5 debate të interpelancës.

| Muaji   | Numri i pyetjeve |
|---|------------------|
| Nëntor 2000 - Qershor 2006 (mesatarja mujore) | 0.5              |
| Qershor (prezantimi i PSK)                    | 19               |
| Korrik  | 8                |
| Shtator                                       | 10               |
| Tetor   | 7                |
| Nëntor  | 15               |
| Dhjetor                                       | 7                |
| Janar   | 8                |
| Shkurt  | 10               |
| Mars  | 20               |
| Prill   | 12               |
| Maj   | 24               |
|   |                  |
|   |                  |
|   |                  |





# Ligji i Bullgarisë Kundër Diskriminimit dhe roli i OJQ-ve në avokimin dhe implementimin e tij

Polina Roussinova, Juriste në Komitetin Bullgar të Helsinkit,

prezantuese në fjalimin kryesor në tryezën e rrumbullakët mbi 'Implementimin e Ligjit Kundër Diskriminimit', 18 prill 2007, Kosovë.

Ligji i Bullgarisë Kundër Diskriminimit, Akti për Mbrojtje kundër Diskriminimit (AMKD), i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2004, i hartuar në përputhje me legjislacionin kundër diskriminimit të BE-së, nga ekspertët perceptohet të jetë një instrument i suksesshëm dhe që funksionon mirë, si dhe një nga ligjet kundër diskriminimit më progresiv në tërë Evropën. Ky vlerësim i lartë është dhënë për shkak të standardeve të ngritura të mbrojtjes që sigurohen nga ky ligj, dhe shfrytëzimin aktiv të mjeteve ligjore që i ofron për luftimin e praktikave diskriminuese përmes proceseve gjyqësore kundër diskriminimit të ngritura nga OJQ-të që përfaqësojnë interesin publik.

Procesi i konsultimeve gjatë hartimit të AMKD-së ishte shënuar me një përfshirje aktive të aktivistëve për të drejtat e njeriut dhe të organizatave të grupeve të rrezikuara, të cilët kanë kontribuar në bartjen e plotë të direktivave të BE-së në fushën e kundër diskriminimit. Në të vërtetë, avokimi i OJQ-ve gjatë procesit të hartimit të ligjit ka avancuar edhe më tej adoptimin e standardeve edhe më të larta dhe mundësive më të mëdha për mbrojtjen e viktimave, në krahasim me ato që parashihen me ligjin e BE-së. AMKD-ja bullgare ndalon diskriminimin në të gjitha sferat e jetës shoqërore më tepër se fushat e cekura në Direktiva; ajo etiketon nxitjen për të diskriminuar si vetë diskriminimin, që është diçka më e gjerë se "të udhëzuarit për të diskriminuar" që përmban teksti i Direktivave, si dhe segregacionin racor dhe ambientin arkitektural që nuk

ofron qasje dhe në këtë mënyrë bart barrën e provës në rastet që kanë të bëjnë me këto forma shtesë të diskriminimit. Në këtë mënyrë, ai jo vetëm që rekomandon, por gjithashtu ua jep për detyrë organeve shtetërore për të adoptuar masa pozitive për të arritur mundësi të barabarta për të gjithë. Prandaj, përpjekjet e grupeve që përfaqësojnë interesin publik që janë investuar në procesin e hartimit të ligjit paraqesin një mundësi jo vetëm që thjeshtë të bëhet kopjimi i standardeve evropiane, por gjithashtu edhe për zhvillimin e një modeli të mbrojtjes më të avancuar dhe pasurimin e Ligjit Kundër Diskriminimit me praktikatat lokale.

Proceset gjyqësore sipas AMKD-së, e në veçanti ngritja e padive strategjike, është padyshim instrumenti më i fuqishëm dhe më detyrues për të nxitur reformat që synohen përmes legjislacionit, si dhe për të përhapur mesazhin se kjo pjesë e legjislacionit ka për qëllim që të shpërndahet në tërë shoqërinë. Përmes këtyre proceseve gjyqësore, Komiteti Bullgar i Helsinkit dhe OJQ-të tjera që përfaqësojnë interesin publik, kanë pasur për qëllim që të sfidojnë diskriminimin sistematik të personave me origjinë romë në sfera të ndryshme të jetës si dhe përjashtimin e tyre shoqëror nga arsimimi cilësor, punësimi dhe ofrimi i shërbimeve; diskriminimi në bazë të gjinisë, në veçanti në fushën e punësimit ku gratë kanë përfaqësim të tepërt në postet vartëse, marrja e pagave më të ulëta dhe ballafaqimi me shumë vështirësi gjatë avancimit; politikatat diskriminuese të qeverisë

përmes izolimit dhe lënies pas dore të personave me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore; diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe mohimi i dinjitetit të barabartë të personave lesbik, homoseksual, biseksual dhe transseksual (LHBT).

Një nga rastet më strategjike të profilit të lartë që është ndërmarrë deri më sot sipas AMKD-së, me ndikim serioz publik ka qenë rasti i ngritur nga Komiteti Bullgar i Helsinkit së bashku me 70 OJQ të tjera dhe personalitete prominente kundër deputetit dhe udhëheqësit të partisë parlamentare të ekstremit të djathtë Ataka, Volen Siderov. Ky rast ka sfiduar propagandën e tij përmes fjalimeve sistematike dhe radikale të urrejtjes që i kishte përcjellur përmes medive dhe përmes tribunës parlamentare, kundër një spektri të gjerë të grupeve minoritare siç janë romët, myslimanët, turqit, çifutët dhe homoseksualët. Pikësynimi më i gjerë i procesit gjyqësor ishte për të adresuar fenomenin e fjalimit të urrejtjes dhe nxitjen e urrejtjes, i cili është përhapur në shtresa të ndryshme të shoqërisë bullgare. Gjykata bullgare kishte vendosur që të ndajë rastin në 8 grupe të ndara të procedurave në bazë të identitetit të paditësve, për këtë arsye priten aktgjykime të ndryshme. Vendimi i parë ka qenë pozitiv dhe ishte konstatuar që fjalimi i urrejtjes kishte nëpërkëmbur jo vetëm të drejtat e personave minoritar, por gjithashtu ka qenë i dëmshëm për tërë shoqërinë. Megjithatë, ende mbetet të shihet se cili do të jetë rezultati i gjithmbarshëm i këtyre proceseve gjyqësore dhe se ku do të vihen kufijtë nga ana

e gjykatave ndërmjet lirisë së fjalës dhe propagandës së urrejtjes. Prapëseprapë, këto raste tanimë kanë krijuar një ndikim të jashtëzakonshëm përmes mbulimit të gjerë mediatik dhe përmes nxitjes së debatit publik për kufijtë e lirisë së fjalës në fushat politike.

Përpjekjet e OJQ-ve në proceset gjyqësore kanë pasur ndikim serioz në krijimin e një jurisprudence pozitive sipas AMKD-së. Gjykatat tanimë kanë demonstruar një qëndrim adekuat ndaj mbrojtjes kundër diskriminimit duke marrë vendime edhe kundër organeve qeveritare dhe institucioneve të fuqishme. Komisioni për Mbrojtje Kundër Diskriminimit, si një organ i specializuar që është përgjegjës për monitorimin e implementimit të ligjit, gjithashtu po tenton që të luaj rolin që i është dhënë nga ligji dhe tanimë ka shqiptuar vendime progresive.

Roli aktiv i OJQ-ve që përfaqësojnë interesin publik në zbatimin e AMKD-së bullgare ka kontribuar në forcimin e perceptimit publik për ligjin, jo si shkronja në letër, por si pjesë e legjislacionit që zbatohet në mënyrë efektive në praktikë. Vëmendja shoqërore e tërhequr për ligjin, krahas qëndrimit serioz, si të gjykatave ashtu edhe të Komisionit për Mbrojtje Kundër Diskriminimit, kanë kontribuar në fuqizimin e viktimave për të mbrojtur të drejtat e tyre themelore të njeriut dhe për të përmirësuar pozitën e tyre në shoqëri, e cila, si efekt afatgjatë, shpie gradualisht në arritjen e barazisë të plotë dhe efektive për të gjithë.



## Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respek-timin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgje-gjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legjislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respekthin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevoajt në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinator i ASI-it Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregullt i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

### Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

*Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.) Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.*



### Këshilli redaktues:

Ramë Manaj, Skender Durmishi, Sven Lindholm, Alfonz Lentze, Edmond Efendija, Krenar Loshi, Artan Canhasi, Franklin De Vrieze.

Redaktor: Anna Richards

Grafika dhe faqesja: Shpend Kada, Edi Agagjyshi

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë  
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188  
kontakt: franklin.devrieze@osce.org  
http: //www.osce.org/ kosovo

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini :

OSCE: 1, 4, 5, 6, 7, 10, 11, 16, 17, 18, 19, 21.  
EAR Consortium 3, 8 NDI 14, 23, 25, Koha Ditore 24